

KOSOVA: HISTORI E PRANISHME E NJË SHTETI TË RI



*Aktet e Simpoziumit Shkencor “Kosova: Histori e pranishme e një shteti të ri”,
mbajtur në Universitetin e Lozanës në IDHEAP - Instituti i Studimeve të
Larta në Administratë Publike, 10 shkurt 2018*

ISEAL

ISEAL

Institut Suisse d'Etudes Albanaises
Istituto Svizzero per gli Studi albanesi
Institut Zviceran i studimeve shqiptare
Schweizerisches Institut für albanische Studien

Përgjegjës për botime: Driton Kajtazi, drejtor i ISEAL-it

Përkthimet: Prof. Dr Nerimane Kamberi, Leman Kamberi - Muriqi, Belgzim Kamberi

Redaktimi gjuhësor: Sulejman Dërmaku

Leximi kontrollues: Arbesë Hoxha

Faqosja: Labinot Hasani

Foto*: © BETOGJENI

**Fotoja nga kopertina: 17 shkurt 2008, Lozanë, Riponne ish-Universiteti i Lozanës, në ditën e shpalljes së Pavarsisë së Kosovës. Manifestimi më i madh në botë, jashta vendeve ballkanike, me mbi 12'000 persona.*

Aktet e Simpoziumit Shkencor “Kosova: Histori e pranishme e një shteti të ri”, mbajtur në Universitetin e Lozanës në IDHEAP (Institut i Studimeve të Larta në Administratë Publike), 10 shkurt 2018.

Këshilli Shkencor i Simpoziumit:

Dr. Olivier Meuwly (kryetar), Dr. Laurent Matthey, Dr. Régis Marion-Veyron, Alain Maillard, Mentor Ilazi.

Shoqata e Studentëve Shqiptarë në Universitetin e Lozanës (AEAUL) dhe Shoqata e Miqve të ISEAL-it (aA-ISEAL) e kanë mbështetur këtë Simpozium.

Simpoziumi është realizuar me përkrahjen e:



Hôtel Pont de la Venoge (Echandens)

Përmabajtet e botimit reflektojnë pikëpamjet e hartuesve dhe jo domosdoshmërisht ato të ISEAL-it.

KOSOVA: HISTORI E PRANISHME E NJË SHTETI TË RI

ISEAL

2019

KOSOVA: HISTORI E PRANISHME E NJË SHTETI TË RI

PËRMBAJTJA

OLIVIER MEUWLY <i>KOSOVA: NDËRTIMI I NJË SHTETI-KOMB NË KOHËN E «POSTNACIONALIZMIT»</i>	9
DAFINA BERISHA <i>FJALIM MIRËSEARDHJE</i>	23
MENTOR ILAZI <i>FJALIM MIRËSEARDHJE</i>	25
BESIM KAJTAZI <i>REPUBLIKA E KOSOVËS: NJË SHTET I RI ME LEGJISLACION TË RI</i>	29
HAXHI GASHI <i>SISTEMI GJYQËSOR PËR NJË SHTET TË RI- Progresi dhe vështirësitë</i>	39
IBRAHIM BERISHA <i>SHOQËRIA E KOSOVËS: NDËRTIM APO RINDËRTIM</i>	51
NAIM JERLIU <i>10 VJET PAVARËSI: SPROVAT E SHËNDETËSISË NË KOSOVË</i>	63
ROLAND NIKLAUS <i>E DREJTA E PRONËS DHE NOTERIA NË KOSOVËN E PAVARUR</i>	75
SAFET GËRXXHALIU <i>KOSOVA KA NEVOJË PËR EKONOMI TË DIJES</i>	83
SÉBASTIEN GRICOURT <i>QË NGA VITI 1999, DY DEKADA PËR NJË USHTRI TË KOSOVËS</i>	91

OLIVIER MEUWLY

KOSOVA: NDËRTIMI I NJË SHTETI-KOMB NË KOHËN E «POSTNACIONALIZMIT»

Olivier Meuwly

Të kremtosh ndryshe dhjetë vitet e shtetit të Kosovës

2018: shteti i Kosovës feston 10 vite të ekzistencës. Ngjarja është e rëndësishme dhe tejkalon kuadrin e kremtimeve që janë zhvilluar brenda dhe jashtë kufijve të shtetit më të ri të shteteve që përbëjnë hartën e Evropës. Kosova është pa dyshim, ende dhe gjithnjë, një entitet i brishtë, por lindja e tij na mëson shumë mbi zhvillimin e Evropës të gjysëm-shekullit të fundit dhe sidomos i propozon vëzhguesit një terren të jashtëzakonshëm përvoja.

Kontinenti evropian ka një histori të stuhishme. I përbërë nga një numër i madh të shteteve të ndërtuara që moti, i ndarë përgjatë katër dhjetëvjeçarëve nga një perde e hekurt që simbolizon vetë luftën e ftohtë që erdhi pas konfliktit të dytë botëror, ai paraqiste një pamje që e nuhasnim të përfunduar. Pa i llogaritur ngjarjet që përgjakën ish-Jugosllavinë, si skenë tragjike e spazmave të fundit të perandorisë sovjetike. Fillonte një periudhë e re e historisë evropiane, plotë paqartësi.

Lindi një shtet i ri, pa histori shtetërore: Kosova. Ky fat i habitshëm gudulis kureshtjen: si ndërtohet një shtet në fillim të shek. XXI? Ç'udhë që ngjitet thikë duhet të përdorë që të mund të emërohet si «Shtet i së drejtës»? Si mundet një shtet të bëhet me administratë, struktura performuese, pa të kaluar shtetërore dhe pasi të jetë përjetuar për gati se një dhjetëvjeçar një lloj «protektorati» të bashkësisë ndërkombëtare (OKB dhe BE)?

Këto janë çështjet të cilat ISEAL-i ka dashur t'i shqyrtojë gjatë simpoziumit të 10 shkurtit 2018, dhjetë ditë para përvjetorit të dhjetë të krijimit të shtetit kosovar. Nuk ishte ideja të bëhet bilanci i dhjetëvjetorit të ekzistencës së tij. Ajo që i interesonte ISEAL-it ishte që të mund të reflektohet, jo për procesin vetëm e vetëm politik që ka shpier në deklaratën e pavarësisë, por për procesin më institucional mbi të cilin është mbështetur ndërtimi i një strukture shtetërore në një territor që ishte në masë të madhe pa strukturë. Për të bërë këtë, nuk mjaftonte të shqyrtoheshin ngjarjet që nxitën Kosovën

të shkurorëzohet nga Serbia, në një sfond të tensioneve që shpërtheu nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë. Nëse kjo histori nuk ka zbuluar ende të gjitha sekretet e saj, thurja e saj është përgjithësisht e njohur. Më interesant na dukej shqyrtimi i ndërtimit të një administrate publike, të ndikuar nga puna e kryer (pak a shumë mirë, e të cilën nuk e trajtojmë me këtë rast) nën drejtimin e institucioneve ndërkombëtare, OKB-së dhe Bashkimit Evropian, por në një terren kryesisht të djerrë, marrë parasysh modelin e referencës.

Të kuptosh krijimin e Kosovës në realitetin e tij konkret

Sepse shteti i Kosovës është krijuar pothuajse «ex nihilo». Dikur juridikisht pjesë e Republikës së Serbisë sipas Kushtetutës së vitit 1974, e që kishte të gjitha të drejtat e një republike para se të shfuqizohet autonomia e saj pesëmbëdhjetë vjet më vonë, e varur pastaj nga diktatet e fuqive «mbrojtëse», Kosova është dashur të shpiket si një shtet-komb dhe ta mendojë një kuadër normativ efikas, duke ëndërruar një fat brenda bashkësisë ndërkombëtare aspak të njëzëshme mbi nevojën e krijimit të një shteti të ri ballkanik, por edhe mbi ligjshmërinë e tij në aspektin e së drejtës ndërkombëtare: si të njësohen respekti i integritetit territorial në njërin anë dhe e drejta e vetëvendosjes në anën tjetër? Për t'u përpjekur të kuptohet se si Kosova - rajon shqipfolës i plagosur nga një luftë e dhunshme të paraprirë nga shumë vite represioni - është bërë shtet-komb i njohur nga 115 shtete sot, nuk qe e mundur të trajtohen të gjitha aspektet përbërëse të një shteti modern. Jemi fokusuar në disa prej tyre, duke shpresuar që disa analiza të tjera do të shpalosin pjesët e tjera të rrugëtimit që ka shpier në krijimin e Kosovës.

Megjithatë, kuadri institucional është qendror. Ai është trajtuar në tri pikëpamje, të cilat i zhvillon ky publikim. Besim Kajtazi tregon se si është ndeshur procesi i emancipimit të institucioneve kosovare të patronizuara nga jashtë drejt një pozicioni të aftë për ta mbështetur ndërtimin e një shteti të së drejtës në përputhje me kriteret e Bashkimit Evropian.

Haxhi Gashi referohet në transformimin e institucioneve juridike në një trup të gjyqtarëve të besueshëm profesional, të aftë për ta interpretuar në mënyrë adekuate një sistem juridik që ishte rimenduar plotësisht pas rënies së komunizmit.

E në fund, për ta përmbyllur këtë kapitull me karakter institucional, Roland Niklaus jep një rast konkret dhe thelbësor për përqëndrushmërinë e jetës

sociale: të drejtën notariale, pa të cilën të gjitha të drejtat e pronësisë do të ishin iluzore. Ai ka marrë pjesë në mënyrë të drejtëpërdrejtë në ndërtimin e tij, për shërbimet e Institutit të studimeve të larta notariale.

Por, një shtet nuk reduktohet në strukturat e saja institucionale: ai është poashtu një shoqëri që zbulon një ekzistencë «shtetërore», që fiton legjitimitetin në fuqi përmes veprimit të përditshëm të shërbyesve të tij në shërbim të nevojave të popullatës së tij. Në mesin e tyre, një çështje qenësore për një shtet që ka përjetuar luftën: shëndetësia. Naim Jerliu shpjegon si është ndërtuar sistemi i shëndetësisë në Kosovë, me shqetësimin për të garantuar cilësinë dhe afërsinë në organizimin e kujdesit mjekësor. Pastaj Sébastien Gricourt përshkruan se si është ngritur një forcë e sigurisë kosovare, si një premtim përfundimtar dhe ende i porealizuar përfundimisht deri më sot, në realitetin ndërkombëtar të një shteti, në një kontekst delikat të artikuluar në integrimin e një ushtrie çlirimtare në strukturat shtetërore. Safet Gërxhaliu interesohet për problemet ekonomike, që janë jetike për mbijetesën e shtetit kosovar, duke e vendosur në perspektivën e sfidave të së ardhmes. Por një shtet para së gjithash përbëhet nga njerëzit që e formojnë një shoqëri, një komb, para se të jenë anëtarë të një tërësie administrative. Ibrahim Berisha paraqet lindjen e përshkallëzuar të një shoqërie në një shtet të ri, larg klisheve që e pengojnë shpesh vizionin objektiv, por edhe duke mos fshehur po ashtu vështirësitë, që kanë shënuar vetëdijësimin e ngadaltë të veçorive të tyre në një univers të trazuar dhe atyre që e presin.

Në djepin e shtetit liberal dhe social modern

Por para se t'ia japë fjalën këtyre ekspertëve të Kosovës së sotme, ja vlen të rikujtohet konteksti historik në të cilin ka zënë vend ngjarja e krijimit të këtij shteti-komb të ri të shek.XXI. Pa këtë kthesë përmes së kaluarës do të ishte e vështirë të kuptohen veçoritë, duke pasur parasysh që e tërë historia kombëtare është kontribuese e ngjarjeve që prodhohen pak a shumë larg kufijve të tij dhe të frymës së kohës. Kur heshtën gjyket në fund të luftës së dytë botërore, shumë shpejt, kontinenti duket sikur i ngrirë nën kaosin e luftës së ftohtë. Një formë e re shtetërore vendoset nën mbrojtjen e ombrellës bërthamore të Shteteve të Bashkuara. E dalur nga rrënojat e sistemeve pak a shumë demokratike njëherësh të përçmuara, që në përfundim të Luftës së Parë Botërore, pastaj të turpëruar nga totalitarizmat, kjo formë e shtetit synon të pajtoj nën autoritetin e saj parimet e lirisë

të zhvilluara në shek.XIX dhe një vokacioni social, themelet e të cilit janë skicuar në vitet 1880. Ballkani duket larg këtij realiteti: megjithatë, ky do të formësojë shpirtërat dhe ndikojë në mënyrë të zhdrejtë fatin e ardhshëm të këtij rajoni.

Fundi i luftës përshpejtoi konkretizimin si shtet të llojit njëkohësisht providencial dhe liberal, teorizuar nga anglezi Beveridge. Ai duhet t'i paqëtojë shoqëritë perëndimore duke i imunizuar kundër të gjitha joshjeve për rrjedhje drejt fashizmit, nacizmit ose komunizmit. Për ta prekur këtë rezultat, në një sjellje antikomuniste që do të shërbente për të përafruar socialistët me bindje socialdemokrate dhe të djathtën «borgjeze», liberale ose historikisht katolike-konservatore, shteti modern në lindje realizon një sintezë ku njihen së bashku përmes një loje të koncesioneve reciproke, nevoja për një ekonomi të tregut, një mbrojtje të besueshme ushtarake dhe një sistem të sigurisë sociale. Këto duhet të garantojnë një siguri ekonomike minimale për klasat e nëpërkëmbura, për të papunët dhe personat në moshë të shtyer. I ushqyer nga rritja e jashtëzakonshme ekonomike që e shoqëron, kryesisht, përgjatë tridhjetë viteve të pasluftës, shteti providencial, tani e tutje në drejtim në të gjitha shtetet demokratike, ngazëllehët në një kuadër me sa duket të ruajtur nga çdo lloj aksidenti.

Duke ia kushtuar një lloj konsensusi të institucionalizuar midis një të djathtë dhe një të majte që janë kujdesur për të shkëputur të gjitha marrëdhëniet më ekstremet, demokracitë e lindura nga lufta organizohen në idenë e pjesëmarrjes së pushtetit të hapur për të gjitha partitë. Për shembull, më 1959, socialdemokracia gjermane shkëputet nga të gjitha referencat marksiste, veprim ky që do t'ia mundësojë asaj që të ngjitet në mënyrë demokratike në pushtet dhjetë vite më vonë, në një moment të parë përmes një koalicioni me demokristianët shumicë që nga paslufta.

Po të njëjtin vit, në Zvicër, shtet neutral, katër partitë kryesore ndajnë midis tyre pothuajse në mënyrë mekanike shtatë mandatet e qeverisë federale. Të gjithë binden se po hyhet në periudhën e «fundit të ideologjive»: vet emri është dosido i ndaluar, sistematikisht i nënkuptueshëm me totalitarizmat. Demokracitë perëndimore krenohen duke u përqendruar në menaxhimin e shteteve, në një dialog të vazhdueshëm midis forcave të ndryshme politike dhe partnerët socialë. Efikasiteti ekonomik është prioritet, mbështetur nga një konsumim çdo herë e më shumë i shfrenuar, e i favorizuar nga një prosperitet që duket i përjetshëm. Politika duhet të kufizohet në një administratë të shëndoshë, në një rishpërndarje të planifikuar ndaj fryteve të rritjes ekonomike. Kapitalizmi i organizuar nuk parapëlqen debatet e ideve, që shihen si të dëmshme për paqen civile.

Nga 68 në 89: gjenerata e përmbysjes

Por kjo formë shtetërore ngeçë në aspiratat e gjeneratës së lindur gjatë ose pas luftës.

Për shumë syresh, socialdemokracia, duke u lidhur me «borgjezinë» për t'i administruar më mirë profitet e rritjes nëpërmjet një anti-komunizmi të përbashkët, ka tradhtuar idealet e tij, në një klimë kulturore që vetëm se riprodhon skemat e paraluftës. Në Francë, ku rinia nuk e gjen veten tutje në «golizmin» në pushtet që nga viti 1958, në Gjermaninë e kllaposur në një denazifikim që do të dështoj për nga sipërfaqshmëria e tij, në Shtetet e Bashkuara të ngatërruara në luftën e Vietnamit me aromë neokolonialiste, kjo gjeneratë e gjykon shtetin të shtrënguar në reflekset e saj autoritare dhe të verbër ndaj dëshirës në lindje për një liri më autentike. Njëkohësisht, çdo gjë që kujton një ideal kombëtar është e urryer, si një kujtim i dëmshëm të nacionalizmave të viteve '30, fajtorë të luftës dhe fatkeqësive. Emancipimi i individëve nuk mundet të mendohet tutje në një shoqëri të lidhur me funksionime të vjetra. Liria e vërtetë duhet të kalojë nëpërmjet çlirimit të individit nga të gjitha lidhjet që e lidhin nga traditat shtypëse: shoqëria duhet të ikë nga mbikëqyrja e një shteti që konsiderohet si një shërbyes i kapitalizmit dhe të pajtohet me vetën e tij, të ushqyer nga spontaniteti i individëve.

Është koha e së «Majtës së Re». Duke hequr dorë nga kujdesi i socialdemokratëve, ajo përpiket ta çlirojë shprehjen e shoqërisë, në emër të interesave të saj reale, të cilat beson t'ia parashikojë qenësinë. Liria duhet të jetë e plotë që të shprehet në realitet: ajo duhet të kalojë përmes trupit, seksit, po aq sa përmes shpirtit. Të gjithë të shtypurit ose ata që konsiderohen të tillë e gëzojnë këtë të drejtë: gjithsesi punëtori, por edhe gruaja, tjetri, natyra. Kufijtë janë të ndaluar, «no limit» ngadhënjën. Feminizmi, antikolonializmi, ekologjizmi shfaqen në këtë periudhë, me qëllim ta rindërtojnë politikën jashtë skemave të zakonshme. Rritja ekonomike bëhet armiku, në çmendurinë e saj shkatërruese të një mjedisi nganjëherë të humanizuar. Megjithatë, Lëvizja e quajtur «Gjashtëdhjetë e tetësja» nuk është pa kundërthënie të thella. Në kundërshtim të ashpër me idenë e kombit, ajo identifikohet me luftën e popujve të kolonizuar për lirinë e tyre pa dashur të shoh se lëvizjet që shpiejnë vendet e e botës së tretë në sovranitet janë realisht shtete nacionaliste nën xhingla marksiste. Të pasionuar për barazinë dhe duke e parë kapitalizmin si një vektor të një

dehumanizmi vdekatar, ata shohin dalluari maoizmin si një rrugë drejt një të ardhme irenike.

Krizat ekonomike që provokuan krizat e naftës të 1973 dhe 1979 do ta përmbyllin diskreditimin e shtetit-komb «tradicional», edhe të veshur më një llakë providenciale, e tashmë të kontestuar në mënyrë të ashpër nga «E majta e re». Ai sulmohet për shkak të paaftësisë së tij për t'i mbajtur premtimet e tij të dhëna në vitet '50. Ja pra dëshmia, për lëvizjet e viteve '60, se rindërtimi i plotë i shoqërisë dhe funksionimeve të tij politike ishte tashmë urgjent. Por nën mburojën e një shoqërie që duhej rimenduar në një vizion të majtë, ku liria kuptohet vetëm se si e ndërlidhur më një barazi të përsosur, disa ide të tjera enden heshturazi. Në Shtetet e Bashkuara, në shtetet e hipive dhe "Woodstock", kjo etje për liri nuk kufizohet më me këngën e «Majtës së Re»: nëse duhet të jetë e plotë, ajo nuk mund ta ndalojë pasurimin, jo vetëm shpirtëror, por edhe financiar... Ajo që do të quhet «neoliberalizmi» lindë në një frymë të "gjashtëdhjetë e tetës" që zbulon tjera ambicie, para se të ngritet në vitet e '80. Dhe një e «Djathtë e Re» do t'i përgjigjet shumë shpejtë së «Majtës së Re»: po aq kundërshtare ndaj kapitalizmit të organizuar në modelin social-liberal se anti-teza e saj, ajo kundërpërgjigjet në mënyrë të përsosur në fushën e vlerave. Për këtë rrymë, kundërpesha ndaj lirisë së shfrenuar të kërkuar nga 68 nuk qëndron në shtetin burokratik, por në kombin. Në atë moment, ai është marginal. Zgjidhja e tij do të ndodhë në një gjeneratë më vonë.

89: kthimi i kombeve

Ngjarja e kaplon botën me gjakftohësi. Në klimën postmoderniste dhe «postnacionale» të viteve '60, Evropa perëndimore ishte organizuar në një ideal që duhet t'i tejkalonte shtetet kombëtare për ta krijuar një konstruksion të pashembullt, në gjysëm-rrugë midis Shteteve të Bashkuara të Evropës dhe shteteve teknokratike kombëtare të përqendruara në menaxhimin e sistemeve të ndryshme providenciale, nën bashkërendimin e Brukselit. «Postnacionale», të fiksuar nga dëmet e supozuara të kufijve dhe ritualisht të ripërsëritura që njëzet vjet, Evropa politike në formim i kishte larguar tekstet e historisë të krijuara në kornizat kombëtare ose shumë tradicionaliste: studimi i historisë duhet të reflektonte supozimin e vlerave të riformuluara në vitet '60, ku kombi duhej të përjashtohej si relik i një periudhe të përfunduar, si shkak i vetëm të tragjedive të shek.XX. Ky është

modeli me sa duket i pranuar nga të gjithë që e vënin në pikëpyetje '89. Logjikisht, shtetet e dalura nga orbita sovjetike kthehen sidomos në drejtim të Bashkimit Evropian. Për ata, kjo nënkupton shkëputjen përfundimtare me totalitarizmin komunist në të cilën kanë jetuar dhe zyrtarizon hyrjen e tyre në qarkun e vërtetshëm të shteteve demokratike. Ata do të jenë në realitet thellësisht të destabilizueshëm për një Bashkim Evropian të mbështjellur në bindjen e tij se historia do të shkruhej tanimë e pastruar nga fjala «komb». Sepse e kundërta prodhohet. Për shtetet e çliruara nga robëria komuniste, çështja është ta rizbulojnë historinë e tyre kombëtare të cilën e ndjejnë se iu kishte grabitur. Si do të reagojë atëherë Evropa politike e cila përpiket ta mendojë veten përtej një kombi të gjykuar të kufizuar, nëse jo reaksionare? Me arsye, ajo pranoj duarhapur këto shtete të sapongarendura në parajsën e lirisë. Por kjo mikëpritje entuziaste e bujare në planin financiar, shpërfaqet me keqkuptime të thella, të cilat nuk janë mënjeluar ende sot. Shtetet e Evropës Lindore përjetojnë vetën në një frymë kombëtare të rigjetur, jo në një «postnacionalizëm» të cilin e vlerësojnë të sterilizuar. Bashkimi Evropian është në pozitë të vështirë: nuk zotëron më instrumentet konceptuale për t'i përvetësuar ndjenjat e të porsaardhurve të rinj. Dy botëra mendimesh përballen.

Këtë mospajtim intelektual, Evropa «postnacionale» kishte filluar ta eksperimentojë në vitet e '80-ta, por pa qenë e vetëdijshme për këtë. Sepse, që nga ajo kohë, Evropa njëkohësisht liberale, pastaj «neoliberale» dhe sociale është zhytur në një krizë të thellë morale. E bindur se kombi nuk përbën më një forcë emocionale e denjë për nga emri për popujt evropian, Evropa institucionale nuk e kupton lindjen e lëvizjeve të cilësuar «populliste» (një term që e kam të pamundur ta analizojë këtu siç e meriton). Zhvillimi i tyre përforcohet në fillim të shekullit, përplasjet nga globalizimi ekonomik dhe shpërthimi teknologjik që tejkalon kufijtë. Ky «popullizëm» përqafon disa forma, në një luftë të përbashkët kundër «elitave», të djathta dhe të majta, kozmopolite dhe teknokratike, që thuhet se nuk mërzhiten për interesat e vërteta të «popullit», të veshur me dije autentike. Në të djathtë, kjo pakënaqësi shprehet përmes kanalit të një diskursi nganjëherë të prirur për përjashtim të të huajve, që bredhin në rrugët e ekzodit për shkak të dëmeve të ekonomisë së globalizuar dhe për dashurinë për «kryqëzim» që shfaqin këto elita të shkëputura nga realiteti. Për të majtën, tashmë koha ka ardhur për t'ia kthyer pushtetin njerëzve të zakonshëm, si viktimat e modernitetit ekonomik që simbolizohet me Bashkimin Evropian, si frut të një pakti fatal të bërë midis liberalëve dhe socialistëve.

Kosova: një shtet në krijim në një Evropë që duhet rikrijuar

Por, të dy «popullizmat» bashkohen në nevojën «kombëtare» të veprimit të tyre, me Bashkimin evropian si shënjestër të ndëshkimit të tyre. Pa dyshim se dy «nacionalizmat» nuk mbivendosen. Ai i së djathtës orientohet qartësisht drejt një përparësie «kombëtare», krejtësisht konservatore dhe sot në modë sidomos në disa shtete të lindjes. Popullizmi i majtë sheh më shumë në shtetin-komb një digë kundër të këqijave që i kushtohen «neoliberalizmit», që mendohet se ka toleruar socialdemokracia klasike. Megjithatë: kombi është rishfaqur në tavolinën e qeverive edhe pse për këto parti, «kombi» është vetëm petku i këtij populli të mitifikuar duke pretenduar secili në mënyrën e vet të qenit zëdhënësit e tij të vetëm. Pra është në këtë kontekst të çuditshëm, gjenerues i një shoku «kulturor», përmasat e të cilit ende nuk i kemi të qarta ende sot, që shtetet ish-komuniste, sot anëtare të Bashkimit Evropian, janë bërë pjesë e radhëve të shteteve demokratike, e sidomos Kosova. Kjo e fundit me një veçori: shtetet e tjera zotëronin një strukturë shtetërore, si shtete zyrtarisht sovranë ose anëtare të federatës. Kosova ishte vetëm krahinë... e cila është dashur të ndërtohet me «kumbarët», entitetet mbikombëtare dhe shtetet që përballeshin me kërkesa kombëtare legjitime, por të paafta për të parë se si përshtatet me në një botë që supozohej e «çkombëtarizuar»...

Ky rikujtim i kontekstit historik të veçantë, shumë rrallë i theksuar, nuk duhet ta shfajësojë Kosovën nga gabimet e bëra që nga shpallja e njëanshme të pavarësisë së saj. Përkundrazi. Në anën tjetër, ai duhet ta mundësojë rivendosjen e krijimit të këtij shtetit-komb të ri në ambientin e një momenti politik të pareduktueshëm nga një lexim shumë linear. Ishte i komplikuar mjedisi gjeopolitik ku e ndërton vendin e tij, edhe pse nuk është vendi këtu për ta komentuar sjelljen nganjëherë ambivalente të fuqive që e kanë sjellur Kosovën në gërmat e pagëzimit. Por nuk ishte as kuadri filozofik. Ai shpjegon po ashtu një gabim të zakonshëm në mesin e shteteve «protektuese» të Kosovës, një gabim që veç e kishin bërë gjatë dekolonizimit: dorëzimin në makthin e padurimit... Tranzicionet drejt demokracisë të llojit perëndimor mund të jenë vetëm të gjata dhe ato i binden një mori kushtesh. E këto shtete kanë pasur shpesh prirje të kërkojnë rezultate të shpejta, nëpërmjet një zhvendosjeje fillestare të rregullave të tyre në një kontekst shumë të ndryshëm.

Nga këto vjen interesimi për t'i shqyrtuar me imtësi proceset që e shoqërojnë

ndërtimin e shtetit të Kosovës. Për ta vlerësuar më mirë punën e kryer, për ta identifikuar atë që është kryer mirë, për ta dalluar edhe atë që nuk ka funksionuar sa duhet në vendosjen e institucioneve mjaft komplekse.

Jo për ta bërë bilancin e çështjeve pozitive dhe negative, siç është thënë në hyrje të këtij teksti. Por për t'i identifikuar problemet që lidhen me ndërtimin e një shteti të ri dhe elementet që duhen ta mbajnë vëmendjen e atyre që shqetësohen me fatin e Kosovës. Problemet janë ende të shumta. Kuptimi i tyre përbën një periudhë të domosdoshme për ta përgatitur një të ardhme të qetë për një shtet ende të brishtë. Qëllimi ynë është arritur nëse ky publikim mund të sjellë një kontribut modest për këtë punë. T'i falënderojmë autorët e mbledhur këtu për pjesëmarrjen e tyre, në këtë këmbim mendimesh që është vetëm në fillesat e tij.

Dr. Olivier Meuwly, historian,
Kryetar i Këshillit Shkencor të Simpoziumit

DAFINA BERISHA

Fjalim mirëseardhje i Dafina Berishës, zëvendës-kryetare e Shoqatës së Studentëve Shqiptarë të Universitetit të Lozanës

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj,

Kam nderin ta marrë fjalën përgjatë disa minutave, në cilësinë e zëvendës-kryetares së Shoqatës të Studentëve Shqiptarë të Universitetit të Lozanës, për të folur në emër të gjithë anëtarëve të saj.

Për mua është një kënaqësi e vërtetë t'ju dëshiroi mirëseardhje në këtë simpozium i cili edhe kremton dhjetë vitet e pavarësisë së Kosovës, nëpërmjet mendimit shkencor lidhur me ndërtimin e shtetit të ri në epokën tonë bashkëkohore.

Së pari, më lejoni ta shpreh privilegjin që e kemi sot si shoqatë studentore që të marrim pjesë në një ngjarje të tillë. Përpjekjet dhe puna që e bëjmë si shoqatë marrin kuptim falë momenteve si ky dhe ngjarjeve shkencore si kjo e juaja sot.

Vërtetë, kur përmendim ekzistencën tonë si Shoqatë e Studentëve Shqiptarë, e bëjmë përmes një forme të veçantë të dashurisë për vendin tonë të prejardhjes dhe përmes interesimit që e kemi për historinë dhe kulturën e tij.

Shoqata jonë kulturore ekziston për ta bërë të kuptueshme, për ta njohur dhe për ta bërë të njohur kulturën shqiptare, si dhe historinë e saj – jo për shkak se është më e mirë se të tjerat, por thjesht sepse e meriton sikurse të tjerat.

Pra, aktivitetet tona ndërtohen së pari përmes vullnetit për të njohur, gjurmuar dhe hulumtuar atë që karakterizon kulturën, në të gjitha aspektet e saj, tokat tona të prejardhjes, të cilat do të mund t'i quanim «tokat shqiptare», pjesë e së cilave është Kosova. Në këtë logjikë, kur trajtojmë ndonjë kulturë, e nevojshme është të ndalemi edhe mbi historinë e saj dhe sfidat e saj që e karakterizojnë lindjen dhe buthtimin e vendit që e mirëpret këtë kulturë.

Së dyti, për ne është t'i ofrojmë një publikut sa më të ndryshëm, konferenca, tryeza, projekte filmash, etj. të cilat prekin tema po aq politike, sa edhe historike ose edhe ekonomike. Kjo na mundëson të mendojmë bashkërisht

mbi sfidat shoqërore, kulturore dhe politike të sotme dhe të dikurshme. Si student dhe studente që jemi, prania jonë këtu është për neve jo vetëm një pasurim të njohurive tona për këtë shtet të ri siç është Kosova dhe të cilin e kemi në zemër, por kjo na jep sidomos mundësi t'i zhvillojmë mendimet përmes paraqitjeve shkencore dhe të ndryshme të folësve të sotëm. Në emër të organizatorëve të kësaj ngjarje dhe të shoqatës sonë, ju falënderoj të gjithëve për praninë dhe ju uroj një simpozium të shkëlqyeshëm.

MENTOR ILAZI

Fjalim mirëseardhje i Mentor Ilazit, anëtar i komitetit të Shoqatës së Miqve të ISEAL-it

Zonja, Zotërinj,

Më lejoni t'ju dëshiroj mirëseardhje në këtë simpozium shkencor në emër të Shoqatës së Miqve të ISEAL-it.

Ne jemi një shoqatë e vogël me 180 anëtarë dhe kemi si shumëzues të përbashkët miqësinë e madhe me Institutin ISEAL.

Kam nderin të jam në mesin tuaj sot për ta kremtuar përvjetorin e dhjetë të pavarësisë së Kosovës. Mosha dhjetëvjeçare është ajo kur jam shkëputur nga toka e vendlindjes sime për të shkuar në Zvicër, një tokë e premtuar ku kam mundur t'i përjetojë vlerat demokratike që kultivoheshin në familjen time dhe të ëndërrojë që populli im, vendi im i prejardhjes, të mund të jetojë një ditë në një shoqëri të lirë dhe demokratike.

Kosova duhet të tejkalojë ende shumë sfida, por shpresa për t'i tejkaluar ato është edhe më e madhe. Megjithatë, ne jemi të vetëdijshëm që nuk mjafton shpresa, e që duhet më shumë mbrehje në punë për ndërtimin e një shoqërie demokratike.

Sepse Kosova është një shtet në ndërtim dhe jo një shtet në tranzicion. Diaspora e din që roli i saj është i rëndësishëm në këtë proces. Ajo nuk ndalon së pyeturi dhe ta rishikojë veten, lidhur me kontributin e saj modest që mund ta sjellë ende për vendin e saj të prejardhjes. E qartë se ka përparim. Dikur flisnim për mbijetesë, sot flasim për probleme.

Do të vazhdojmë të vendosim gurë për ndërtimin e Kosovës dhe paqen e qëndrueshme në Ballkan.

BESIM KAJTAZI

REPUBLIKA E KOSOVËS:

NJË SHTET I RI ME LEGJISLACION TË RI

NË VEND TË HYRJES

Kuvendi i Kosovës, më 17 shkurt 2008, në Prishtinë, ka shpallë Deklaratën e Pavarësisë¹ së Kosovës dhe nëpërmjet saj ka shpallur Kosovën shtet të pavarur.

Nëpërmjet Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, Republika e Kosovës ka marrë obligime ndërkombëtare, që më pas ndikuan, me kompromise të shumta, edhe në procesin e hartimit dhe miratimit të Kushtetutës, por edhe të legjislacionit tjetër².

Pas shpalljes së Pavarësisë, deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me 9 prill 2008, kanë miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës³, dhe kjo datë është shpallur si Dita e Kushtetutës⁴. Kushtetuta, ka hyrë në fuqi më 15 qershor 2008⁵.

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me datën 22 korrik 2010, ka konfirmuar ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, të miratuar më 17 shkurt 2008⁶.

Republika e Kosovës, sikurse është përcaktuar me Kushtetutë, është Republikë demokratike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera, e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre. Në këtë drejtim, secili prej pushteteve ka përgjegjësitë e veta të ndara dhe mekanizmat përkatës për të kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Kuvendi i Republikës së Kosovës, ushtron pushtetin legjislativ - Kuvendi miraton ligjet. Presidenti i Republikës së Kosovës, përfaqëson unitetin e popullit, është përfaqësues legjitim i vendit brenda dhe jashtë dhe garantues i funksionimit demokratik të institucioneve të Republikës së Kosovës. Presidenti shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi. Qeveria e Republikës së Kosovës harton projektligjet dhe ia paraqet Kuvendit për miratim, është përgjegjëse për zbatimin e ligjeve e politikave shtetërore dhe

¹ http://kuvendikosoves.org/common/docs/Dek_Pav_sh.pdf

² <https://unmik.unmissions.org/sq/rezoluta-1244-e-kombeve-te-bashkuara>

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

⁴ Vendimi i Kuvendit të Kosovës- Legjislatura e III-V-027- 9 prill 2008.

⁵ Shih Nenin 162 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës;

⁶ Shih http://www.ambasada-ks.net/be/repository/docs/ICJ_Opinion_Kosovo_Independence_22_Jul_2010.pdf

i nënshtrohet kontrollit parlamentar. Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur dhe ushtrohet nga gjykatat. Gjykata Kushtetuese, është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bën interpretimin përfundimtar të Kushtetutës.

SFIDAT PËR KRIJIMIN E NJË SISTEMI TË RI LIGJOR

Kosova, shteti më i ri në familjen evropiane, në procesin e shtetndërtimit u ballafaqua dhe po ballafaqohet me sfida të ndryshme për krijimin e një sistemi të ri ligjor, të bazuar në parimet e lirisë, paqes, demokracisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit, drejtësisë sociale, pluralizmit, ndarjes së pushtetit shtetëror dhe ekonomisë së tregut.

Hartimi i legjislacionit në Republikën e Kosovës, është një nga sfidat më të mëdha, duke qenë njëkohësisht një nga proceset e pashmangshme, të domosdoshme për ndërtimin dhe forcimin e një shteti ligjor dhe demokratik.

Kosova, megjithëse shtet i ri, ka trashëguar probleme të vjetra, për sa i përket legjislacionit të aplikueshëm, dhe ky fakt shkakton jo pak probleme tek zbatuesit e legjislacionit.

Republika e Kosovës, pa përvojën e mëhershme shtet formuese (vend nën regjimin komunist jugosllav, për më shumë se një gjysmë shekulli 1945-1999), me një paralizim të plotë dhjetëvjeçar (1989-1999) të jetës institucionale, kur shqiptarët ishin të përjashtuar tërësisht nga jeta shoqërore, politike dhe arsimore, e dalë nga lufta (1997-1999) pothuajse e shkatërruar, sa në planin e infrastrukturave po aq edhe në planin shoqëror, të gjitha këto kanë reflektuar dhe po reflektojnë akoma në mungesën e kapaciteteve të duhura në hartimin e legjislacionit.

Nuk duhet anashkaluar as fakti tjetër se pas luftës, në Kosovë, ka pasur prioritetë të tjera dhe nuk ka pasur sa duhet mundësi për kujdes të duhur në ngritjen e kapaciteteve të nevojshme për të hartuar politikat dhe legjislacionin, që do të reflektonte dhe adresonte nevojat reale të vendit.

Synimi që Republika e Kosovës të përfshihet në proceset integruuese Euroatlantike, obligimet që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim Asociim, procesi i liberalizimit të vizave dhe procesi i harmonizimit të legjislacionit kosovar me atë të Bashkimit Evropian (BE-së), kanë ndikuar dhe do të ndikojnë

ndjeshëm që kjo veprimtari legislative të intensifikohet edhe më shumë. Ndërtimi i kapaciteteve të administratës publike, në hartimin e politikave dhe legjislacionit, është një nga proceset më të vështira dhe më të kushtueshme për Kosovën. Mirëpo, ky proces, sa i nevojshëm aq edhe i domosdoshëm, duhet të vazhdojë, ngase duhet pasur parasysh se, në mungesë të kapaciteteve për hartimin e politikave dhe legjislacionit, hartohet legjislacion joadekuat, e me një legjislacion joadekuat pakësohet siguria dhe stabiliteti ligjor, si dhe kemi zbatim të pamjaftueshëm të normave ligjore dhe si rrjedhojë dëmtohet sundimi i së drejtës dhe pengohet realizimi i të drejtave të njeriut.

Ndërkaq, siguria ligjore, stabiliteti ligjor dhe sundimi i së drejtës janë parakushte thelbësore të reformës ekonomike dhe të përmirësimit të mirëqenies dhe kushteve të jetesës të qytetarëve të Kosovës, gjë që e bëjnë më të domosdoshëm që procesit të hartimit, miratimit dhe zbatimit të legjislacionit t'i kushtohet vëmendje më e madhe, meqë çdo investim i bërë në këtë drejtim do të kthehet si përfitim i shumëfishtë.

PERIUDHAT KRYESORE TË HISTORIKUT TË HARTIMIT TË LEGJISLACIONIT NË KOSOVË (1999-2018)

Për të kuptuar procesin e hartimit dhe të legjislacionit në fuqi, është e nevojshme edhe njohja e proceseve të ndryshme nëpër të cilat ka kaluar Kosova, që nga paslufta e deri më sot (1999-2018). Edhe pse në dukje është një kohë e shkurtër, gjatë kësaj kohe ka pasur zhvillime të shumta.

Procesi i hartimit të legjislacionit në Kosovë, gjatë viteve 1999-2018, është ballafaquar me sfida që janë unike dhe që nuk janë hasur në asnjë nga vendet evropiane. Zhvillimet dhe proceset në Kosovën e pasluftës kanë ndikuar edhe në procesin dhe në procedurat e hartimit të legjislacionit.

i. Periudha e UNMIK-ut (1999-2001) - Rezoluta 1244, e miratuar më 10 qershor 1999, nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, që me ndihmën e organizatave të tjera ndërkombëtare, të vendosë një prani ndërkombëtare civile në Kosovë, e njohur me emrin Misioni i Administratës së Përkohshme i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK).



Gjatë kësaj periudhe, gjithë pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv, në lidhje me Kosovën, duke përfshirë administrimin e organeve të drejtësisë, e kishte

UNMIK-u, ushtruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të Kombeve të Bashkuara.

Për kryerjen e detyrave, që i janë besuar UNMIK-ut, sipas nevojës, i është dhënë mandati që të nxjerrë akte ligjore në formë rregulloresh - të njohura si Rregulloret e UNMIK-ut dhe Urdhëresat Administrative të UNMIK-ut në zbatim të Rregulloreve⁷.

Prej vitit 1999 deri në vitin 2008, nga UNMIK-u janë nxjerrë gjithsej 443 rregullore.

Prej tyre 144 rregullore janë për shpalljen e ligjeve dhe 109 për ndryshimin e rregulloreve si dhe janë nxjerrë 209 urdhëresa administrative, që bënin zbatimin e rregulloreve të UNMIK-ut.



Rregulloret dhe Urdhëresat e UNMIK-ut, siç është përcaktuar në Nenin 145(2) të Kushtetutës, vazhdojnë të zbatohen për aq sa të jetë në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë, derisa të mos shfuqizohen, zëvendësohen ose amendamentohen në pajtueshmëri me këtë Kushtetutë.

ii. *Periudha e qeverisjes së kontrolluar (2001-2008) - Krijimi i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë - PSSP, më 15 maj 2001, ka miratuar Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/9 për Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, e njohur si Korniza Kushtetuese⁸, duke krijuar mundësitë e krijimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes - IPVQ-ve, të cilat janë: Kuvendi i Kosovës, Kryetari i Kosovës, Qeveria, gjykatat dhe organet e institucionet e tjera, të parapara në Kornizën Kushtetuese. Përmbajtja e Kornizës Kushtetuese*


⁷ Rregulloret e UNMIK-ut janë miratuar dhe janë nënshkruar nga PSSP-ja dhe kanë hyrë në fuqi në datën e caktuar në rregullore. Rregulloret e UNMIK-ut kanë mbajtur shenjën UNMIK/REG/, të shoqëruara me vitin e nxjerrjes dhe numrin e nxjerrjes së atij viti. Rregulloret e UNMIK-ut janë nxjerrë në gjuhën angleze, shqipe dhe serbe. Në rastet kur ka pasur mospërputhje, ka vlejtur vetëm teksti në gjuhën angleze. Rregulloret janë botuar në Gazetën Zyrtare të UNMIK-ut në letër dhe në formë elektronike.

⁸ http://www.unmikonline.org/regulations/unmikgazette/03albanian/A2001regs/RA2001_09.pdf

tregon një gërshetim të një qeverisjeje ndërkombëtare dhe vendore, që këtë akt e bën sui generis, siç është e tillë edhe situata në Kosovë nën administrimin ndërkombëtar. Periudha e bashkëqeverisjes (2001-2008) apo periudha e kalimit gradual të përgjegjësiave dhe kompetencave nga UNMIK-u tek IPVQ-të, gjatë së cilës institucionet ndërkombëtare dhe ato vendore kanë pasur kompetenca për nxjerrjen e akteve normative - secila në fushën e vetë të përgjegjësiave, duke pasur parasysh që kompetencat dhe përgjegjësitë e IPVQ-ve nuk përfshijnë disa kompetenca dhe përgjegjësi të rezervuara, të cilat kanë qenë ekskluzivisht në mandatin e PSSP-së.

Gjatë kësaj periudhe IPVQ-të filluan të nxjerrin ligje edhe akte nënligjore gjegjësisht udhëzime administrative.

Krahas Gazetës Zyrtare të UNMIK-ut ku publikoheshin rregulloret dhe urdhëresat e UNMIK-ut, nga data 1 qershor 2006 filloi të botohet edhe Gazeta Zyrtare e IPVQ të Kosovës, e cila publikohej sikurse Gazeta Zyrtare e UNMIK-ut, në pesë gjuhë: në gjuhën shqipe, serbe, angleze, turke dhe atë boshnjake.



Rrugëtimi i ligjit në kohën e bashkëqeverisjes (2001-2008)

iii. *Periudha e Pavarësisë së Mbikëqyrur (2008-2012)* - Gjatë Periudhës së Pavarësisë së Mbikëqyrur (2008-2012), institucionet e Republikës së Kosovës kanë pasur mandatin të nxjerrin aktet normative, por duke marrë parasysh kompetencat e përcaktuara me Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës (26 mars 2007) dhe mandatin e përcaktuar për Përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil, siç edhe është përcaktuar me Kushtetutë.

Grupi Drejtues Ndërkombëtar, i përbërë nga shtetet të cilat e njohën Kosovën, i dha fund mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë me datën 10 shtator 2012.

Për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë dhe heqjen e mandatit të Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar, ishte i nevojshëm

amendamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe disa ligjeve të tjera në të cilat ishin përcaktuar roli dhe të drejtat e Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar. Në këtë drejtim, fillimisht u bënë 22 amendamente të Kushtetutës dhe ndryshimet dhe plotësimet e 21 ligjeve që kishin të bënin me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Gjatë kësaj periudhe filloi të botohet Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës⁹ si i vetmi publikim zyrtar në Republikën e Kosovës ku publikohen ligjet dhe aktet tjera të institucioneve të Republikës së Kosovës.


iv. *Periudha e Pavarësisë - Rruga e Republikës së Kosovës drejt BE-së (2012 e tutje)* – Pas përfundimit të mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës morën mandatin e plotë për nxjerrjen e akteve përkatëse normative.

E drejta e nismës për të propozuar ligje i takon: Presidentit, nga fushëveprimtaria e saj/tij; Qeverisë; deputetëve të Kuvendit si dhe më së paku dhjetë mijë qytetarëve¹⁰.

Në Republikën e Kosovës, sikurse edhe në shumicën e vendeve me sistemet parlamentare, mbi nëntëdhjetë (90%) për qind të projektligjeve propozohen nga Qeveria (Në Kosovë 96%).

Rëndom, rrethi i zakonshëm i hartimit dhe finalizimit të një ligji, fillon me hartimin e projektligjit nga ministria përkatëse dhe miratimin nga Qeveria, duke vijuar me miratimin e ligjit nga Kuvendi, me shpalljen e tij nga Presidenti dhe publikimin në Gazetën Zyrtare.

Figura e mëposhtme paraqet numrin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi gjatë pesë legjislaturave të deritanishme.



⁹ <https://gzk.rks-gov.net/>

¹⁰ Shih Nenin 79 të Kushtetutës. E drejta e nismës për të propozuar ligje realizohet sipas mënyrës së përcaktuar me Ligjin nr. 04/-L-025 për nisma legjislative, me Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës (29.04.2010) dhe me Rregulloren nr. 09/2011 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Aspirata e Republikës së Kosovës është që të jetë pjesë e shteteve të BE-së. Për të arritur këtë aspirim, kërkohet që Kosova ta harmonizojë legjislacionin e saj me atë të BE-së.

Që nga paslufta janë bërë përpjekje të shumta për të krijuar një sistem të mirëfilltë që rregullon procesin e hartimit të legjislacionit, ku përfshihet edhe procesi i përputhshmërisë së legjislacionit të Kosovës me Acquis-in dhe tanimë është në fazën finale të ndërtimit të këtij procesi. Me ç'rast është miratuar legjislacioni dhe janë themeluar strukturat përkatëse¹¹.

Procesi i përafrimit të legjislacionit është puna më e madhe dhe më gjithëpërfshirëse në procesin e anëtarësimit. Në këtë drejtim, Kosova ka dhe janë vendosur proceset e përafrimit të legjislacionit.

SUNDIMI I LIGJIT

Krahas procesit të hartimit të legjislacionit, vëmendje e njëjtë duhet kushtuar edhe zbatimit të tij.

Në Republikën e Kosovës, me fitimin e lirisë, sfida mbetet që kjo liri të zhvillohet nën sundimin e ligjit.

Në Republikën e Kosovës aspirata dhe dëshira për zbatimin dhe sundimin e ligjit duhet të jetë e njëjtë me dëshirën për lirinë e saj, dhe vetëm atëherë do të kemi zbatim të mirëfilltë të legjislacionit dhe do të mbretërojë sundimi i mirëfilltë i drejtësisë.

Besim M. KAJTAZI

Drejtor i Departamentit për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare
Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës

¹¹ Shih Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovë nr. 09/2011, Rregullores nr. 13/2013 për Shërbimin Ligjor Qeveritar (17/06/2013) dhe Udhëzimin Administrativ nr. 03/2013 për Standardet e Hartimit të Akteve Normative (17/06/2013),

HAXHI GASHI

SISTEMI GJYQËSOR PËR NJË SHTET TË RI

Progresi dhe vështirësitë

1. Kosova në 10 vite Pavarësi: Zhvillimet para dhe gjatë pavarësisë

1.1 Hyrje

Kosova si një shtet i ri, përfaqëson një rast të veçantë të ndërtimit të shtetit, institucioneve përfshirë këtu sistemin juridik dhe gjyqësor. Sistemi juridik dhe gjyqësor reflekton vetë zhvillimet nëpër të cilat ka kaluar Kosova. Këto zhvillime e bëjnë Kosovën një rast të veçantë. Për të kuptuar tërë rrjedhën e ngjarjeve, duhet vështiruar zhvillimet në Kosovë në disa faza. Andaj, edhe qëllimi i këtij punimi është këndvështrimi i shkurtër i zhvillimit të sistemit gjyqësor në Kosovë në 10 vjetorin e Pavarësisë.

1.2 Kosova gjatë ish-Jugosllavisë dhe viteve 90-ta

Kosova ka një histori të gjatë të ndërtimit institucional. Që në kohën e ish-Jugosllavisë ishte pjesë konstituive e Federatës sipas Kushtetutës së viti 1974. Në aspektin institucional i kishte të gjitha institucionet dhe ndarjet e pushteteve: Legjislativin që ishte kompetencë e Kuvendit të Kosovës, Ekzekutivin (Këshilli Ekzekutiv) dhe Gjyqësorin të organizuar nga, Gjykata Suprem, Gjykatat e Qarkut, Gjykatat Komunale. Po ashtu në hierarkinë e institucioneve ekzistonte edhe Dhoma e Veçantë e Gjykatës Kushtetuese. Përveç ligjeve në nivelin federativ, Kosova e kishte të drejtën e nxjerrjes së ligjeve të veta për terrorin e Kosovës, kuptohet në harmoni me ligjet e ish-federatës.

Një strukturë e këtillë e institucioneve vazhdon deri me 22 Mars 1989 kur me forcë nga Serbia, Kosovës i merret autonomia dhe shpërbëhen institucionet e saja Kushtetuese.

1.3 Kosova gjatë viteve 1990-1999

Nga viti 1989 deri në vitin 1999, Kosova vazhdon nën një regjim të masave diskriminuese në legjislacion dhe në institucione. Gjatë këtyre viteve popullsia shqiptare largohet dhunshëm nga vendet e punës, nxjerrën ligje diskriminuese dhe ushtrohet dhunë ndaj popullatës. Si rezultat i dhunës me 1998-1999 fillon lufta për mbrojtje dhe çlirim nga okupimi. Pas Konferencës ndërkombëtare të Rambujes dhe Paris, me disa takime në shkurt dhe deri me

18 Mars 1999, ku nënshkruhet nga pala Kosovare, ndërsa nuk nënshkruhet nga pala Serbe, hapet rruga e intervenimit ushtarak ndërkombëtar me ndihmën e NATO-s për të ndalur luftën dhe mbrojtur popullin e Kosovës nga masakrat dhe një eksod masiv i popullatës shqiptare dhe dëbimit nga Kosova. Pas 78 ditë sulmesh arrihet edhe kapitullimi i Serbisë dhe përfundimi i luftës, ku si ditë e çlirimit konsiderohet 12 Qershori 1999.

1.4 Kosova pas vitit 1999 deri 2008 nën administrimin e UNMIK-ut

Pas përfundimit të luftës në Qershor të vitit 1999, Kosova vendoset nën administrimin ndërkombëtar të quajtur UNMIK (Misioni i Përkohshëm i Kombëve të Bashkuara) në bazë të Rezolutës së OKB-së 1244. UNMIK-u e kishte autoritetin final në të gjitha funksionet dhe përgjegjësitë shtetërore dhe e ushtronte përmes, Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP)¹². Funksionet e UNMIK-ut ishin ndarë në 4 shtylla; 1) shtylla e I, Politika dhe Drejtësia, 2) shtylla e II, administrimi civil, 3) shtylla e III, demokratizimi dhe ngritja e kapaciteteve udhëhequr nga OSBE dhe 4) shtylla e IV zhvillimi dhe rindertimi ekonomik.

Krahas UNMIK-ut, në Kosovë zhvillohen edhe Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës–IPVQ. Baza e organizimit institucional rregullohej me Kornizën e Përkohshme Kushtetuese të miratuar nga Kuvendi i Kosovës dhe nënshkruar nga PSSP në vitin 2001¹³. Sipas kësaj Kornize, Kosova kishte Kryetarin, Parlamentin, Qeverinë, dhe Gjykatat të organizuara në gjykatat themelore, gjykatat e qarkut dhe gjykatën supreme. Këto organe kanë dalur pas zgjedhjeve të përgjithshme nën mbikëqyrjen e bashkësisë ndërkombëtare. Ndërsa sistemi gjyqësor është zhvilluar si degë e pavarur e pushtetit shtetëror me organ mbikëqyrës Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorinë. Po ashtu Kosova e kishte të drejtën e nxjerrjes së ligjeve por që i nënshtroheshin kontrollit nga UNMIK-u përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së.

Pushteti nga UNMIK-u te Institucionet e Kosovës barte në mënyrë graduale varësisht nga progresi që tregonin institucionet në aspektin funksional dhe sundimin e ligjit. Kështu që kompetencat në ministri, shtimi i ministrive të caktuara dhe në fushën legislative vareshin nga ky progres.

¹² Shih Rregullorja e UNMIK-ut, nr.1999/1, për autorizimet e administratës së përkohshme në Kosovë, 25 qershor 1999.

¹³ Shih Korniza Kushtetuese e Kosovës e aprovuar me rregulloren UNMIK-ut, UNMIK/REG/2001/9 15 maj 2001.

1.5 Konfuziteti i legjislacionit

Si rezultat i rrethanave të reja të krijuara pas luftës, krijohet një konfuzitet i legjislacionit që zbatohet në Kosovë. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 për legjislacionin e zbatueshëm në Kosovë¹⁴, si ligje të zbatueshme konsideroheshin; ligjet në fuqi në Kosovë para 22 Mars 1989, Rregulloret e UNMIK-ut, Ligjet e nxjerra nga Kuvendi i Kosovës. Ligjet e nxjerra pas 22 Mars 1989 mund të zbatoheshin nëse 1) ka zbrazëturë ligjore dhe 2) nuk kanë karakter diskriminues. Po ashtu në Kosovë zbatoheshin drejtpërdrejtë edhe standardet dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Me këtë strukturë të legjislacionit ishte shumë e vështirë funksionimi i një sistemi të mirëfilltë të drejtësisë për shkak të konfliktit të madh të ligjeve dhe bazave të ndryshme ligjore. Për më shumë ishte e vështirë se cili ligj kishte përparësi ndaj tjetrit.

1.5 Plotësimi i standardeve para statusit

Gjatë periudhës 1999-2008 Kosovës i janë vendosur disa kushte para se të definohet statusi final politik. Këto quheshin “Standardet para statusit”, dhe si qëllim kishin detyrimin e Kosovës që të shënonte progres të theksuar dhe bindës për bashkësinë ndërkombëtare lidhur me sundimin e ligjit, funksionimin e institucioneve sipas standardeve më të mira ndërkombëtare, zhvillimin ekonomik etj. Përmbushja e këtyre standardeve verifikohej nga një komision i veçantë i deleguar për këtë qëllim.

1.6 Plani Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Final – Plani i Marti Ahtisarit

Pas rekomandimit se janë plotësuar standardet e kërkuara nga bashkësia ndërkombëtare, hapi tjetër drejtë përcaktimit të statusit politik final të Kosovës, ishte edhe emërimi i ekipit negociatorë të ndërmjetësuar nga përfaqësuesi i posaçëm i Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së Marti Ahtisari. Pas një periudhe të gjatë bisedimesh, arrihet edhe Plani Gjithëpërfshirës i Ahtisarit për zgjedhjen e statusit të Kosovës, i datës 26 Mars 2007. Me këtë Plan është paraparë edhe shpallja e Pavarësisë së Kosovës.

¹⁴ Shih Rregullorja e UNMIK-ut, nr. 1999/24 për ligjin e zbatueshëm në Kosovë, 12 dhjetor 1999.

2. Shpallja e Pavarësisë së Republikës së Kosovës

Me 17 shkurt 2008 Kosova e shpalli Pavarësinë e saj dhe është njohur deri më tani nga 114 shtete, ku procesi i njohjeve ende vazhdon. Me 9 Prill 2008, miratohet Kushtetuta e Republikës së Kosovës e cila ka hyrë në fuqi më 15 Qershor 2008. Me Kushtetutë është rregulluar organizimi shtetëror, dhe Kosova përcaktohet për shtet demokratik, sundim të ligjit dhe respektim të standardeve më të larta ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Me nenin 22 të Kushtetutës standardet dhe marrëveshjet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut janë të zbatueshme - drejtpërdrejtë në Kosovë. Po ashtu është e zbatueshme edhe praktika e Gjykatës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Me Kushtetutë parashihet edhe Autoriteti i Përfaqësuesit Ndërkombëtar Civil (PNC/ICO) në Kosovë që do të mbikëqyrë edhe zbatimin e planit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës (shih Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 146 dhe 147). Kështu në Kosovë fillon faza e pavarësisë së mbikëqyrtur nga bashkësia ndërkombëtare. Kjo mbikëqyrje vazhdoj deri në vitin 2012 ku nga Përfaqësuesi i Zyrës Ndërkombëtare Civile konstatohet përmbushja e standardeve të kërkuara me Planin e Ahtisarit dhe përfundimi i Pavarësisë së mbikëqyrtur. Në këtë kohë edhe plotësohen edhe ndryshon ligjet për të përfunduar mandatin e mbikëqyrjes ndërkombëtare në Kosovë¹⁵. Nga viti 2012 vazhdon në Kosovë një mision tjetër ndërkombëtar për sundim të ligjit Misioni Evropian i quajtur EULEX. Me kërkesë të Serbisë të inicuar rastin kundër Pavarësisë; Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND) me 22 Korrik 2010, deklaroi se Kosova e ka shpallur Pavarësinë në pajtim me të drejtën ndërkombëtare.

3. Sistemi Gjyqësor dhe Prokurorial në Kosovë

3.1 Konsolidimi i sistemit emergjent gjyqësor në vitin 1999

Menjëherë pas luftës në vitin 1999 është bërë konsolidimi i sistemit gjyqësor në mënyrë emergjente me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare dhe institucioneve vendore. Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ishte kompetent për sistemin gjyqësor. Fillimisht është funksionalizuar gjykata e qarkut në

¹⁵ Shih ligji nr. 04/l-115, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Prishtinë me 30 Qershor 1999. Deri në fund të vitit 1999 janë aktivizuar edhe gjykatat e qarkut në Pejë, Mitrovicë, Gjiilan, Prizren. Mbikëqyrja e sistemit gjyqësor dhe prokurorial nga UNMIK-u ka vazhduar deri në vitin 2008, kur shpallet Pavarësia e Kosovës dhe miratohet edhe Kushtetuta. Gjatë viteve 1999-2008 janë nxjerrë ligje dhe rregullore për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor duke siguruar funksionimin e gjykatave dhe prokurorive në të gjitha nivelet. Duhet shtuar se brenda sistemit gjyqësor funksiononin edhe gjyqtarë dhe prokuror të emëruar nga UNMIK-u, dhe me kompetencë që të merrnin në shqyrtim çdo lëndë që ata e konsideronin me rëndësi të veçantë dhe prioritet.

3.2 Sistemi Gjyqësor dhe Prokurorial pas shpalljes së pavarësisë

Me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, determinohet ndarja e pushteteve në Legjislativ, Ekzekutiv dhe Gjyqësor. Sistemi Gjyqësor është një pushtet i ndarë dhe i pavarur nga pushtetet tjera¹⁶. Sistemi gjyqësor dhe prokurorial është rregulluar me disa ligje¹⁷. Sistemi gjyqësor ndahet në gjykatat e rregullta: Gjykatat Themelore, Gjykata e Apelit, dhe Gjykata supreme¹⁸. Gjykatat themelore janë themeluar në Prishtinë, Gjiilan, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë. Këto gjykata i kanë edhe degët e tyre në territoret e komunave më të vogla. Gjykata e Apelit, kompetente për të vendosur për ankesat kundër vendimeve të gjykatave themelore ndodhet në Prishtinë. Po ashtu, Gjykata Supreme kompetente për të vendosur për mjete të jashtëzakonshme juridike, ndodhet në Prishtinë. Gjithashtu, për sigurimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut themelohet edhe Gjykata Kushtetuese. Ndërsa për çështje pronësore, funksionojnë edhe Agjencioni i Pavarur i Pronave, kompetent për zgjidhjen e çështjeve pronësore gjatë periudhës 1998-99 dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme për çështje të privatizimit.

Po ashtu, në Kosovë funksionojnë Prokuroritë Themelore, e Apelit dhe Kryeprokurori i Shtetit. Brenda prokurorisë funksionojnë edhe prokuroria speciale e specializuar për rastet e korrupsioni dhe krimit të organizuar.

¹⁶ Shih Kushtetuta e Republikës së Kosovës, miratuar me 9 Prill 2008, dhe hyrë në fuqi me 15 Qershor 2008, Kapitulli VII, sistemi i drejtësisë.

¹⁷ Ligji për Gjykatat, nr. 03/L-199, Ligji për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nr. 03/L-223, Ligji për Prokurorin e Shtetit, nr. 03/L-225 dhe Ligji për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nr. 03/L-224.

¹⁸ Shih Ligji nr.03/L-199 për gjykatat, Gazete Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 79/24 gusht 2010, neni 8.

Sistemi gjyqësor dhe prokurorial fillimisht është mbikëqyrur nga Këshilli Gjyqësor dhe Prokurorial si organ i pavarur. Më vonë në janar të vitit 2011, është bërë ndarja në Këshillin Gjyqësor përgjegjës për punën e gjyqësorit dhe Këshillin Prokurorial përgjegjës për punën e prokurorisë së shtetit.

Këshilli Gjyqësor është organ i pavarur që siguron pavarësinë dhe paanësinë e sistemit gjyqësor¹⁹. Këshilli ka 13 anëtarë me mandat 5 vjeçar (5 gjyqtarë të zgjedhur nga vetë gjykata dhe 8 anëtarë tjerë të zgjedhur nga Parlamenti). Përzgjedhja e gjyqtarëve bëhet nga Këshilli Gjyqësor dhe përmes konkursit publik, ndërsa emërimi i gjyqtarëve të përzgjedhur bëhet nga Presidenti i Shtetit²⁰. Emërimi i parë bëhet për 3 vjet, ndërsa emërimi i dytë është i pakufizuar deri në pensionim, përveç rasteve kur mandati ju përfundon për shkaqe sipas ligjit²¹.

Këshilli Prokurorial është organ i pavarur që siguron pavarësinë e prokurorisë, qasje të barabartë në drejtësi, përbërje shumetnike, dhe barabarësi në sistem prokurorial, si dhe propozon, avanco, mbikëqyrë, transferon dhe disiplinon prokurorët në bazë të ligjit²². Këshilli përbëhet prej 9 anëtarë, nga të cilët 5 janë nga prokuroritë dhe 4 anëtarë të zgjedhur nga Parlamenti, prej të cilëve ata mund të jenë nga, shoqëria civile, fakulteti juridik, avokatë. Ministri i Drejtësisë dhe Kryeprokurori i Shtetit janë anëtarë ex officio. Prokurori i shtetit (Kryeprokurori) është organ i pavarur. Me propozim të Këshillit Prokurorial, Kryeprokurori emërohet nga presidenti me mandat 7 vjeçarë pa mundësi ri-emrimi. Prokuroret emrohen në mandat fillestar 3 vjeçarë dhe me mundësi ri-emrimi me mandat deri në pensionim, por me mundësin e përfundimit të mandatit sipas kushteve të parapara me ligj.

Kosova ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të përmirësoj profesionalizimin dhe zbatimin e ligjit, pavarësisht shumë vështirësive që ka hasur gjatë ndërtimit të institucioneve të drejtësisë. Ende ka punë që duhet përmirësuar, megjithatë shikuar nga prizmi i sfidave që është ballafaquar, institucionet e ndërtuara po arrijnë të kryejnë funksionin që ngarkohen me ligj.

4. Avokatura

Organizimi i avokaturës bëhet përmes Odës së Avokatëve të Kosovës si një organ i Pavarur dhe i garantuar me Kushtetutë²³. Avokatura në Kosovë

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 108.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 104.

²¹ Po aty, neni 105.

²² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 110.

²³ Shih Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 111.

dhe oda e avokatëve ka qenë e themeluar që nga viti 1973²⁴. Avokatura si profesion i pavarur rregullohet me Ligj të veçantë në të cilin parashihen edhe kushtet për të ushtruar profesionin e avokatit²⁵. Në Kosovë e ushtrojnë profesionin e avokatit një numër i madh i avokatëve të pavarur.

5. Modernizimi i sistemit gjyqësor

Sistemi gjyqësor vazhdimisht është sfiduar për të bërë përpjekje në profesionalizim dhe forcimin e sundimit të ligjit. Në këtë drejtim edhe janë themeluar edhe disa institucione shtesë për të lehtësuar punën e gjykatave, mundësuar qytetarëve qasje me të lehtë në drejtësi dhe për të përshpejtuar zgjidhjen e rasteve para gjykatave. Prandaj, përveç trajnimeve të vazhdueshme për gjyqtarë dhe prokuror, përmes Institutit të Drejtësisë, më vonë Akademia e Drejtësisë, janë themeluar edhe Noteria, Sistemi i Përmbaruesve Privatë, Ndërmjetësuesit.

5.1 Sistemi noterial

Nga nevoja që gjykatat të lirohen nga lëndët që trajtojnë çështjet juridiko-civile në procedurë jo-kontestimore, është themeluar edhe sistemi Noterial në Kosovë²⁶, me mbështetje të projekteve ndërkombëtare (projekti Zviceran për mbështetje për sitemin noterial). Me këtë sistem është mundësuar të fillojnë punën Noterët e parë Maj të vitit 2012. Tashmë ky sistem është mjaft funksional dhe ka mundësuar qasje më të shpejtë dhe zgjidhje të shpejtë të çështjeve civile jokontestimore për qytetarë (si çështjet pronësore, kontrata, trashëgimore, dokumente etj)

5.2 Ndërmjetësimi

Po ashtu me Ligjin për ndërmjetësim²⁷, është paraparë edhe themelimi i sistemit të ndërmjetësimit dhe ndërmjetësuesve të cilët mund të zgjedhin

²⁴ Ligjit mbi Avokaturën dhe Ndihmën Tjetër Juridike, i shpallur në Gazetën zyrtare të Kosovës nr. 43/73, ndryshimet Gz. 46/77, teksti spastruar 19.12.1979 Gz. 48/79.

²⁵ Shih Ligji Nr. 03/L-117/ miratuar me 20 nëntor 2008, i ndryshuar me Ligji nr. 04/L-193 për avokatinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.20/ 31 Maj 2013.

²⁶ Shih Ligji nr. 03/L-010 për Noterinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.42/25 nëntor 2008.

²⁷ Shih Ligji nr. 03/L-057 për ndërmjetësim, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.41/1 nëntor 2008. marrëdhëniet kontestuese në raportet juridiko-pasurore të subjekteve të së drejtës, tregtare, familjare, të punës, raporte të tjera civile, administrative dhe penale, në të cilat palët lirisht mund të disponojnë vullnetin e tyre të lirë, në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo e një organi tjetër kompetent. marrëdhëniet kontestuese në raportet juridiko-pasurore të subjekteve të së drejtës, tregtare, familjare, të punës, raporte të tjera civile, administrative dhe penale, në të cilat palët lirisht mund të disponojnë vullnetin e tyre të lirë, në rast se me ligj të veçantë nuk është paraparë përgjegjësia ekskluzive e gjykatës apo e një organi tjetër kompetent.

me ndërmjetësim shumë çështje të natyrave civile dhe penale por që nuk janë kompetencë ekskluzive e gjykatave. Si të tilla janë: çështjet familjare, penale për vepra penale të caktuara, ekonomike etj.

5.3 Sistemi i përmbauesve privat

Duke pasur vonesa të shumta në përmbarimin e vendimeve gjyqësore, me ligjin për procedurën përmbauese²⁸ është paraparë edhe sistemi i përmbauesve privat. Me këtë janë themeluar zyrat e përmbauesve privat që i kanë dhënë një shpejtësi të madhe realizmit të kërkesave të kreditorëve dhe përmbarimin e vendimeve të gjykatave.

6. Sfidat e sistemit gjyqësor të përmbush misionin e vet për një shtet të ri

Siç u pa më sipër, sistemi gjyqësor është sfiduar në shumë dimensione, që nga mënyra e themelimit, kompleksiteti i legjislacionit, dualizmi i kompetencave në mes të institucioneve vendore dhe atyre ndërkombëtare - UNMIK, ICO, EULEX e deri te mënyra e interpretimit dhe zbatimi i ligjeve. Sistemi është kritikuar në aspektin e vendimeve të cilat jo gjithmonë janë meritore. Megjithatë, në Kosovë zbatohen standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe sistemi gjyqësor bashkë me mekanizmat shtesë ka pasur edhe mbështetje ndërkombëtare, ku kjo është përgjegjësi e ndarë. Duhet theksuar se ndërtimi i sistemit gjyqësor për një shtet të ri ka qenë sfidë, por që ka arritur të kryej misionin e vet, të zhvillohet dhe të jetë sistemi i konsoliduar në aspektin strukturor dhe ligjor. Është bërë përpjekje që siguron një sistem të pavarur dhe të paanshëm dhe profesional. Megjithatë, ka ende punë për t'u bërë për të arritur një shkallë më të lartë për sundimin e ligjit.

7. Përfundim

Kosova si një shtet i ri, paraqet një rast të veçantë të ndërtimit të shtetit por edhe institucioneve përkatëse, në këtë rast edhe sistemit juridik dhe gjyqësor. Vet rruga e zhvillimeve që nga faza e para luftës dhe pas luftës së vitit 1999, mbikëqyrja ndërkombëtare nga misioni UNMIK deri në vitin 2008, më vonë ICO në vitin 2012, EULEX në bashkëpunim dhe me institucionet

²⁸ Shih Ligji nr. 04/L-139 për procedurën përmbaimore, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.3/31 Janar 2013.

vendore të Kosovës, tregon një rrugë specifike të ndërtimit të shtetit, sistemit juridik dhe gjyqësor nën mbikëqyrje ndërkombëtare.

Gjatë rrugës së ndërtimit të sistemit gjyqësor, ka pasur sfida të ndryshme në ndërtimin institucional dhe zbatimin e ligjit, si rezultat i shumë faktorëve; legjislacioni kompleks, dualizmi i kompetencave në mes organeve të ndryshme përfshirë vendore dhe ndërkombëtare, por edhe ballafaqimi me të kaluarën, rastet e luftës, dëmi i shkaktuar nga lufta, korrupsionin sundimin e ligjit etj. Por ka shumë aspekte pozitive, ku në Kosovë me ndihmën e faktorit ndërkombëtar janë ndërtuar institucione që për bazë kanë parimet kryesore të pavarësisë, paanësisë, barabarësisë për të gjitha palët dhe komunitetet që jetojnë në Kosovë. Po ashtu në Kosovë zbatohen drejtpërdrejtë standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut. Janë themeluar edhe institucione mbikëqyrës të pavarura Këshilli Gjyqësor dhe Prokuroria për të siguruar pavarësinë e gjykatave dhe prokurorive. Por Kosova ka shënuar edhe progres në modernizimin e sistemit gjyqësor duke krijuar sistemin noterial, ndërmjetësimin, përmbaruesit privat.

Prof.Asoc.Dr.Haxhi Gashi

Dekan i Fakultetit Juridik

Universiteti i Prishtinës''Hasan Prishtina''

IBRAHIM BERISHA

SHOQËRIA E KOSOVËS: NDËRTIM APO RINDËRTIM

Shoqëria e Kosovës që nga viti 2000 është përfshirë në ndryshime dinamike sociale, politike dhe kulturore në njërën anë dhe ato sisteme-shtetërore në tjetrën. Në këtë punim synohet trajtimi i formave dhe përmbajtjeve të ndryshimeve ndikuar nga transformimet dhe tranzicioni post-konfliktual, krahas ngritjes së një shteti të ri që konvergjon të kaluarën dhe të sotmen si ndërtim dhe rindërtim social. Shtresimet sociale dhe format e paraqitjes së tyre po kështu janë në fokus të shkrimit.

Fjalët kyçe: Shoqëria, Kosova, ndërtimi-rindërtimi, solidariteti, shtresimet shoqërore

Shoqëria e Kosovës ishte e ndarë gjatë gjithë shekullit XX, ndarje që mbështetej në politikat për marginalizimin dhe spastrimin etnik të shqiptarëve si popull shumicë. Identiteti i shqiptarëve u njoh mbas vitit 1945 si pakicë kombëtare dhe pastaj më 1974 si kombësi. Popullit të tretë me numër në Federatën e Jugosllavisë, nuk iu pranua statusi i kombit të barabartë me ata sllavë: serb, slloven, kroat, malazez, maqedon. Izolimi dhe pabarazia e ndërtuar bazuar në identitetin dhe ndarjen nacionale, i la mënjanë nga dinamika e ndryshimeve sociale dhe kulturore. Në vitin 1947 Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia kishin GDP të njëjtë, ndërsa më 1988 në Mal të Zi dhe Maqedoni ajo ishte më e madhe se në Kosovë për 3.6 herë. Shoqëria e solidaritetit dhe autoriteti moral: Shoqëria e solidaritetit dhe autoriteti moral u krijuan nga viti 1990 kur regjimi i Millosheviqit anuloi autonominë e Kosovës të miratuar me Kushtetutën e vitit 1974. U instalua segregacioni dhe shqiptarët mbetën pa punë pasi nëpërmjet masave të dhunshme u kërkohet nënshkrimi i deklaratës për lojalitetin politik ndaj Qeverisë së Serbisë. Kundrejt kësaj, përgjigja ishte: mobilitet dhe homogjenizim nacional. Diskriminimi dhe presioni për lojalitetin politik u transformua në solidaritet kolektiv dhe lojalitetin për autoritetin tradicional, të kombinuar me atë të lidershit karizmatik të promovuar nga lideri Ibrahim Rugova. Shoqëria e përjashtuar nga institucionet legjitime, themeloi institucione alternative politike, financiare, arsimore, shëndetësore, informative, të solidaritetit.

Organizimi institucional alternativ në fillimet e viteve 1990 mbështetej në solidaritetin e fortë dhe të qëndrueshëm kolektiv. Duke qenë shoqëri ende me vlera të theksuara tradicionale, në organizime dhe punë të institucioneve alternative u ndërtua si rregullues, pushteti moral. Ky autoritet rregullonte pjesë të sferës publike, ku humanizmi dhe solidariteti qe ndërtimi shoqëror në Kosovë në vitet 1990 - 1999. Kjo ishte shoqëria e solidaritetit dhe pushtetit të pakontestueshëm të vënë në funksion të mbijetesës dhe të rezistencës. Dhuna dinamizoi lidhjet sociale, kulturore, institucionale, morale, zakonore etj., si dhe gjeneroi vetëdije të re kolektive për veprime e mobilizim rreth idesë për liri dhe shtet, si mundësi mbijetese dhe perspektive kolektive. Në vitet 1998-1999 dhuna e milicisë dhe ushtrisë serbe la të vrarë 13 mijë e 535 persona²⁹, ndërsa vetëm për rreth tre muaj gjatë periudhës mars-qershor 1999 u deportuan jashtë Kosovës 800,000 shqiptarë. Kishte shkatërrime³⁰ dhe djegie në 1100 vendbanime³¹. Ndërsa në vitin 2017 ende ishin 1,666 persona të zhdukur³².

Shtresime të ashpra sociale: Kushtetuta aktuale Kosovën e përcakton si shtet qytetar. Përkundër një varg ligjesh të miratuara, favorizuese për serbët edhe përmes diskriminimit pozitiv, në shoqërinë e Kosovës, grupe sociale, institucione, shoqata, asociacione etj, vazhdojnë të funksionojnë mbi parimin e ndarjes etnike. Nuk është arritur të ndërtohet ende shoqëria që funksionon si një tërësi qytetare. Ndikimi i Qeverisë së Serbisë që serbët e Kosovës të mos integrohen, është përcaktues i kësaj ndarjeje, andaj, veprojnë dy shoqëri dhe sy sisteme politike, arsimore, shëndetësore.

Mbas vitit 2000, krahas transformimit të sistemit politik, ekonomik dhe social, ndodhi rritja e shtresimeve dhe ndarjeve sociale. Marrja e mjeteve mujore si ndihma sociale-solidariteti vullnetar dhe siguria për ekzistencën nga këto ndihma, zvogëluar mobilitetin për të ruajtur traditën për punë në bujqësi, blegtori dhe zejтари dhe kështu nga prodhuesi dhe ofruesit e prodhimeve në treg, u krijua një shtresë e madhe konsumuesish të vlerës që vetë nuk e prodhojnë. Privatizimi i ndërmarrjeve publike, fabrikave dhe

²⁹ <https://telegrafi.com/ne-kosove-per-dy-vjet-jane-vrare-13-mije-e-535-persona> (2.12.2017)

³⁰ Shtëpi të shkatërruara – dëmtuara të popullatës shqiptare: 100.589, Shkolla të shkatërruara – të dëmtuara me dokumentacion: 358, Zyra të vendit: 71, Shtëpi kulture: 30, Biblioteka publike dhe shkollore: 93, Objekte shëndetësore: 123, Objekte fetare (xhami, teqe, tyrbe): 215, Kisha katolike: 5, Objekte ndihmëse – përcjellëse: 88.101.

³¹ Gjenocidi i pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve '90" ASHAK, Prishtinë, 2001

³² [Gazeta zeri.info/.../ja-sa-te-zhdukur-jane-ne-kosove-sipas-kryqit-te-kug/](http://Gazeta.zeri.info/.../ja-sa-te-zhdukur-jane-ne-kosove-sipas-kryqit-te-kug/) (12.06.2017)

tokave rriti dallimet e grupeve sociale, krijoi një shtresë shumë të pasur rreth 2 për qind, ndërsa nën anën tjetër, një popullsi me mbi 30 për qind të papunë (UNDP).

Janë strukturuar disa grupe sociale nga diferencimet e ashpra: tregtarë, biznesmenë, avokatë, pastaj përfitues të luftës, uzurpues të lokaleve, pronave, pozitive zyrtare etj., gjithë kjo në emër të meritokracisë. “Të fortët” forcën fizike dhe fitimin material-financiar përmes mashtrimeve e transformuan në pushtet politik. Një grup të diferencuar social paraqesin edhe zyrtarët dhe qeveritarët, të cilët duke ushtruar forcën e pushtetit dhe pushtetin dhe influencën, përmes korrupsionit dhe veprimeve të paligjshme, pasurohen dhe formatizohen si shtresë e veçantë sociale. Andaj kaosi social krijoi njerëz të pushtetshëm, qeveritarë autoritarë dhe shtet të dobët ku mungon dukshëm zbatimi dhe barazia para ligjit.

Kjo gjendje sociale është shprehur me mungesën e një shtrese të mesme që kish për të treguar dobinë e politikave të mira publike. Mësuesit dhe punonjësit buxhetorë, janë larg të qenit shtresë e mesme, mbasi të ardhurat e tyre mbesin të ulta krahasur me çmimet e larta. Grupim i madh social janë të varfërit, të cilët ose nuk kanë pasuri të trashëguar, ose atë e humbën në luftë apo, për më tepër, nuk kanë mundur të sigurojnë ndonjë vend pune dhe për këtë arsye mbeten të mbijetojnë si kategori e përkujdesur sociale. Pasurimi i shpejtë pa punuar është një tregues për praninë e pandëshkuar të korrupsionit. Institucionet, policia, gjykatat, prokurorët, po edhe EULEX, nuk kanë treguar kurajo të plotë për t’u ballafaquar me korrupsionin dhe krimin e organizuar. Në një hulumtim të opinionit si institucione më të korruptuara në Kosovë janë vlerësuar (nga 1-5): Qeveria 3.01, Kuvendi 2.68. Gjykatat 2.64 dhe Prokuroria 2³³. Më shpejt u ngrit rrjeti i merimangës së korrupsionit se sa shteti ligjor dhe kjo u pasqyrua në ngulfatjen e zhvillimit ekonomik dhe social.

Perspektiva e punës jashtë apo brenda: ndjenja e përjashtimit nga të qenit qytetar i barabartë është e përhapur dhe kjo vërehet më së shumti ndër të rinjtë. Mbi 50 përqind e popullsisë është nën moshën 27 vjeçare, ndërsa 50.9 % e të rinjve nuk kanë një punë³⁴. Adresa më e dëshiruar e punësimit për të rinjtë mbetet sektori publik, anipse i mbingarkuar dhe selektiv me lidhjet familjare si kriter kryesor përzgjedhës. Pasiguria shprehet me faktin

³³ Instituti Riinvest. Vlerësimi i korrupsionit në Kosovë. 2016 www.riinvestinstitute.org/uploads/files/2016/September/15/.pdf (2 dhjetor 2017)

³⁴ ASK. Anketa e fuqisë punëtore. ask.rks-gov.net/media/3574/anketa-e-fuqise-punetore-tm2-2017.pdf (12 janar 2018)

se tregu global i punës shihet si mundësi për të krijuar të ardhmen, ndërsa fare pak ai lokal. Migrimi për të gjetur punë jashtë në vitet e fundit është dinamizuar dhe një shpërthim dramatik ndodhi në vitin 2015 kur përmes rrugëve ilegale u larguan në Evropë 80 mijë qytetarë të Kosovës.

Mobiliteti për arsimim cilësor dhe përgatitje profesionale konkurruese të rinjtë është inkurajues. Po ndërtohet një shoqëri informative me investimet e bëra nga bizneset private, ndërsa të rinjtë janë ndërtues të saj. Qasje interneti në shtëpi më 2017 kishin 88.8 për qind të ekonomive familjare dhe ky është tregues se shoqëria e Kosovës është e ranguar lartë, madje duke qenë lidere në rajon, por njëherësh duke qenë lidere edhe me numrin e analfabetëve me 4.18 për qind të popullsinë mbi 15 vjeç³⁵. Ky është njëri nga pardokset sfidues për shoqërinë.

Shoqëria e Kosovës që e njohur gjatë për trajtimin konzevrtor të gruas, madje trajtimi i saj ishte mbështetur në zgjidhje e botëkuptim “kanunor”. Kjo edhe tani duket me përqindjen e papunësisë, e cila tek femrat është 68,9 për qind, ndërsa tek meshkujt 36,9 për qind. Në procesin e ndërtimit të një pozite të barabartë do pasur rol më aktiv të vetë gruas në lidhje me tabutë gjatë të pranishme, dhe kjo ka të bëjë me realizimin e të drejtës trashëgimore, përgjegjësi të barbartë në familje, për të mos pranuar dhunën e burrit. Po ndërtohet kulturë e re sikur edhe për divorcin që gjykohej si diçka tepër negativ dhe rastet e divorcit kanë qenë të rralla³⁶. Në proces presioni dhe transformimi social u shpreh edhe në një lloj “kohabitacioni vlerash”, që do të thotë, se ato tradicionale nuk u defunksionalizuan tërësisht, por në anën tjetër vlerat bashkëkohore filluan të zënë vend në sjelljet dhe praktikat sociale. Në procesin e transformimit social dhe kulturor është duke u rritur individualizmi dhe shpëputja nga format e sjelljes që ishin dominuese në familjen tradicionale me tre breza.

Në opinionin ndërkombëtar është krijuar një përshtypje se Kosova është një burim aktiv i gjenerimit të ekstremistëve fetarë, në këtë rast muslimanë. Por, shoqëria e Kosovës, në fakt, është shumë tolerante sa i përket besimeve dhe mirëkuptimit fetar. Do referuar të dhënës se pas vitit 1999 janë krijuar sekte fetare³⁷, ndërsa pjesa më e madhe e popullsisë në Kosovë është muslimane dhe praktikisht anëtarët e rinj të këtyre sekteve të krishtera vijnë nga familje muslimane. Nuk ka incidente, armiqësi apo konflikte midis

³⁵ Analfabetizmi- Kosova e para në Evropë?! <https://www.evropaelire.org/a/26572804.html> (11 janar 2018)

³⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK): për vitin 2016 nga Gjykatat Themelore të Kosovës, janë grumbulluar gjithsej 1110 fleta statistikore për shkurorëzime.

anëtarëve të besimeve të ndryshme apo shoqatave fetare. Liritë fetare janë të përcaktuara nga realiteti multietnik, kornizë kjo e afirmimit të identiteteve etnike dhe fetare, nga traditat tolerante fetare të banorëve dhe nga synimi që të adaptohen standardet europiane edhe në punë të respektimit të lirive dhe të të drejtave fetare.

Rezyme

Shoqëria e Kosovës është në proces transformimi social, politik dhe kulturor. Dinamika e ndryshimeve në njërën anë edhe mugesë e shtetit efikas social dhe ligjor në tjetrën, i bën ndryshimet jo rrallë të shprehen me ashpërsi dhe me pasoja, të cilat pasqyrohen te të papunët dhe shtresat e varfëra. Në proces presioni dhe transformimin social shprehet një lloj “kohabitimi vlerash”, ato tradicionale nuk janë funksionalizuar tërësisht, ndërsa vlerat bashkëkohore po zënë vend në sjelljet dhe praktikat sociale. Në procesin e ndërtimit social dhe kulturor është duke u rritur individualizmi. Dominon tendenca e ndërtimit dhe rindërtimit të shoqërisë plurale dhe konkurruese, të lirë dhe të njerëzve të barabartë. Sfidë edhe për kohë të gjatë do të mbetet zbutja e shtresimeve sociale të krijuara shpejt dhe ashpër pa u bazuar në punë dhe në fitime nga puna.

³⁷ Kisha Ungjillore, Kongregacioni i Dëshmitarëve të Jehovait, Kisha Baptiste, Kisha Adventiste, Kisha Hare Krishna, Kisha e Unifikimit, Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme etj.,

Literatura:

- Agani, Fehmi (2002) Demokracia, kombi, vetëvendosja, Dukagjini, Pejë.
- Osmani, Jusuf (2016) Kolonizimi, reforma agrare dhe shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova 1918-1941, Prishtinë.
- Berisha, Ibrahim (2016) Vdekja e Kolonisë, PEN, Prishtinë.
- Berisha, Ibrahim (2015) Utopia reale, OM, Prishtinë.
- Fuga, Artan (2008) Media, Politika, Shoqëria 1990- 2000, Dudaj, Tiranë.
- Horvat, Branko (1985) Jugoslovensko društvo u krizi, Delo, Lubljana.
- Hajriz M., I., Shatri B (2007) Këshilli Qendror për Financim i Kosovës, SHBLSH, Prishtinë.
- Kojçini, Ukaj, Sulltane (1997) Kuadri arsimor shqiptar në Kosovë në shënjestrën e sigurimit... (1945-1952) IH, Prishtinë.
- Kullashi, Muhamedin (2016) Dy gjenealogji të modernitetit, ASHAK, Prishtinë.
- Sabrina, P. Ramet (2009) Tri Jugosllavije (1918-2005), Zagreb
- Sejdiu, Fatmir (2001) Politika agrare si instrument i shtypjes nacionale në Kosovë, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë
- Thompson, Mark (1995) Forging War in former Yugoslavia, Beograd.
- Thomas, M., Mikulan K. (2006) The Yugoslav Wars (1), Slovenia & Croatia 1991-95, Gr.Britain in Osprey Publishing.
- Kosova sot/Kosovo danas (1984) KSAK, Beograd.
- Fuqizimi institucional i Departmanetit të Mirëqenies Sociale (2006) Prishtinë.
- “History is Herstory Too” The History of Women in Civil Society in Kosovo 1980 – 2004, (2008) Prishtina.
- Anketa e fuqisë punëtore. ask.rks-gov.net/media/3574/anketa-e-fuqisë-punëtore-tm2-2017.pdf (12 janar 2018)
- Gjenocidi i pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve ‘90” (2001) ASHAK, Prishtinë.
- Monitorimi i Zbatimit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (CEDAW) në Kosovë” (2009), Prishtinë.
- Doc.Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë 2005-2007, (2008) Banka Botërore, Prishtinë.
- Doc.Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë,(2007) ESK, vol.I.II, Prishtinë.
- Doc. Publikimi i Statistikave të Mirëqenies Sociale TM3 2013, Prishtinë
- Doc. Publikimi i Statistikave të Mirëqenies Sociale TM1 2015, Prishtinë

Raporti i parlajmërimit të hershëm (2008) UNDP, Prishtinë.
Doc.Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2017, ASK, Prishtinë
Doc.Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2016, ASK, Prishtinë.
Doc.Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2015, ASK, Prishtinë.
Doc.Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2014, ASK, Prishtinë.
Raporti i Zhvillimit Njerëzor (2004) UNDP, Prishtinë.
Raporti i parlajmërimit të hershëm 2008 UNDP, Prishtinë.
Raporti i Zhvillimit Njerëzor 2004 UNDP, Prishtinë.
Raporti i parlajmërimit të hershëm 2007, UNDP, Prishtinë.
Doc. Zhvillimi rural 2008 MB, Prishtinë.
Doc Libri i gjelbërt, Ministria e Bujqësisë, 2008, Prishtinë, 2008.
Doc. Zhvillimi rural, MB, Prishtinë, 2008, Prishtinë.

Dr Ibrahim Berisha
Fakulteti I Filozofisë, Departamenti I Sociologjisë
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

NAIM JERLIU

10 VJET PAVARËSI: SPROVAT E SHËNDETËSISË NË KOSOVË

Sfondi: Kosova përmes një tranzicioni të shumëfishtë

Që nga përfundimi i luftës së viteve 1998-99, Kosova është përballur me tranzicione të shumta politike, sociale dhe ekonomike. Në fazën fillestare të pasluftës, popullata e Kosovës u përballë me kushtet shëndetësore dhe gjendjen socio-ekonomike të vështirë, ndërsa sektori i shëndetësisë ishte i shkatërruar pothuajse tërësisht. Që atëherë, janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të rehabilituar dhe funksionalizuar sistemin tonë shëndetësor, duke synuar një sigurim të vazhdueshëm dhe cilësor të kujdesit shëndetësor.

Pas pothuajse një dekade të administrimit nga Misioni i Kombeve të Bashkuara (UNMIK) Kosova e shpalli pavarësinë e saj më 17 shkurt 2008. Janë disa faza që e kanë shënuar procesin e ndërtimit të shtetit në Kosovë, ndër të cilat më e rëndësishmja ishte krijimi i kuadrit ligjor, në përputhje me legjislacionin evropian. Kjo përfshinte miratimin e politikave dhe strategjive për konsolidimin, funksionimin dhe modernizimin e sektorit shëndetësor të Kosovës.

Pavarësisht nga fakti se Kosova nuk është ende shtet anëtar i Bashkimit Evropian (BE), ky shtet i ri është megjithatë në një fazë të hershme në rrugën e vet drejt integritimit në BE dhe duhet të përballët tashmë me standardet e BE-së dhe reformat e politikave në sektorët e kujdesit shëndetësor dhe social.

Kosova – disa të dhëna të rëndësishme

Sipërfaqja: 10,908 km²

Popullsia: 1,895,250 (vlerësim, në korrik 2017)

- 28% nën moshën 15 vjeç
- rreth 50% më të rinj se 28.2 vjet.
- mosha mesatare 30.2 vjet.
- zonat rurale: 61.7%, urbane: 38.3% (2011).

Jetëgjatësia mesatare: 76.7 vite (2011)

- meshkuj 74.1 vjet
- femrat 79.4 vjet.

Një vend me të ardhura të ulëta - GDP: 3,084 € për kokë banori (257 € / muaj); Rritja ekonomike 1.2%; varfëria e përgjithshme 29.2%, varfëria ekstreme 8.2% (Burimi: ASK 2014);

Në vitin 2011, 29.7% e popullsisë jetonin nën kufirin e varfërisë (€ 1.72 / ditë / të rritur) dhe 10.2% nën kufirin e varfërisë ekstreme (1.2 euro / ditë / të rritur);

Papunësia rreth 30%;

Gjysma e popullsisë është nën moshën 30 vjeç dhe gjysma e tyre janë të papunë;

Indikatorët shëndetësor në mesin e më të varfërve në Evropë.

Zhvillimi i sektorit të shëndetësisë në Kosovë

Që nga përfundimi i luftës më 1999, sektori i shëndetësisë në Kosovë mund të thuhet se ka kaluar nëpër dy etapa kryesore:

- I. *Periudha emergjente (199-2002), dhe*
- II. *Periudha e zhvillimit dhe konsolidimit (2002-tutje).*

I. Periudha emergjente (1999-2002) (pas luftës)

Menjëherë pas përfundimit të luftës më 1999 dhe vendosjes së Misionit Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) u ndërmorën një varg masash emergjente që kishin për synim funksionalizimin e sektorit të shëndetësisë që ishte i shkatërruar pothuajse tërësisht. Në tetor të vitit 1999 u hartua i ashtuquajti “Libri i kaltër” - Udhëzimet e Politikave të Përkohshme Shëndetësore, nga përfaqësuesit e UNMIK-ut, OBSH-së, si dhe OJQ-ve të ndryshme, kryesisht ndërkombëtare.

Ndërsa në shkurt të vitit 2001 u hartua dokumenti tjetër i rëndësishëm i njohur si “Libri i Verdhë” - Dokumenti i politikës shëndetësore të Kosovës, që ishte në një mënyrë rishikimi i “Librit të kaltër” në hartimin e të cilit dokument morën pjesë ekspertë vendas dhe mbi bazë të të cilit u funksionalizua edhe Departamenti i Shëndetësisë si institucion pararendës i Ministrisë së Shëndetësisë që do të themelohet më 2002.

II. *Periudha e zhvillimit dhe konsolidimit*

Që nga konstituimi i institucioneve pas zgjedhjeve të para parlamentare në Kosovë dhe themelimi i Ministrisë së Shëndetësisë edhe sektori shëndetësor u fut në një etapë të re të zhvillimit dhe të konsolidimit të vet që mund të konsiderohet se kalon nëpër disa faza.

Faza 1: 2002-2004. Është faza kur vendoset korniza ligjore dhe institucionale e sektorit shëndetësor që do të sanksionohet me aprovimin e Ligjit për Shëndetësinë 2004/4.

Faza 2: 2004-2012. Është faza e ballafaqimit me sfidat e zbatimit të ligjit dhe nismat e rishikimit të tij, që përshkohet kryesisht nga mungesa e efikasitetit financiar, mos krijimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore dhe sistemit të informimit në sektorin e shëndetësisë.

Faza 3: 2012 - tutje. Është faza e re e zhvillimit dhe konsolidimit të sektorit shëndetësor që mbështetet në ndryshimin e Ligjit për Shëndetësi dhe tendencat që synojnë reformimin e sistemit shëndetësor, në vazhdimësi.

Sistemi shëndetësor

Rrjeti i institucioneve shëndetësore

Rrjeti i institucioneve shëndetësore në Kosovë është i organizuar në tri nivele:

- Niveli primar,
- Niveli sekondar dhe
- Niveli terciar.

Kujdesi shëndetësor ofrohet si kujdes: spitalor, ambulator, në shtëpi dhe shërbime emergjente, ndërsa shërbimet ofrohen në institucionet shëndetësore publike dhe private.

Kujdesi shëndetësor primar (KSHP) është i bazuar në konceptin e mjekësisë familjare dhe ofrohet nga një rrjet publik që përfshin gjithsej 430 institucione.

Shërbimet e kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar organizohen brenda *Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK)* si shërbime shëndetësore unike të integruara.

Rrjeti publik i SHSKUK përbëhet nga: Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK); Qendra Stomatologjike Universitare e Kosovës (QSUK), Spitalet e Përgjithshme (në Gjilan, Prizren, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës; Qendra Kombëtare e Mjekësisë Sportive; Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut; Qendra Kombëtare e Telemjekësisë.

Shëndeti publik

Ministria e Shëndetësisë përcakton dhe mbikëqyrë zbatimin e politikave të shëndetit publik nëpërmjet Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës (IKSHPK) si institucion publik që ushtron aktivitete referuese në fushën e shëndetit publik dhe ka rrjetin me Institutet Rajonale të Shëndetit Publik në Gjilan, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Gjakovë dhe Pejë.

Sektori privat

Përveç institucioneve publike shëndetësore, kujdesi shëndetësor në Kosovë sigurohet edhe nga institucionet private mjekësore. Aktiviteti privat në sektorin e shëndetësisë ushtrohet mbi bazën e barazisë së plotë me sektorin publik të shëndetësisë. Në Kosovë funksionojnë gjithsej 1.069 institucione mjekësore private të licencuara (2016). Prej tyre gjithsej 28 janë institucione spitalore dhe të tjerët ofrojnë shërbime jashtë spitalore.

Burimet financiare

Sektori i shëndetësisë në Kosovë financohet kryesisht nga tatimi mbi të ardhurat, taksat dhe bashkëpagesat, ndërsa pagesa private nga xhepi ende mbetet e lartë dhe mbulon rreth 40% të shpenzimeve mjekësore. Buxheti nacional për shëndetësi për vitin 2017 ishte 180 milionë euro, nga të cilat 50 milionë euro janë transferuar në komuna. Kujdesi shëndetësor sekondar dhe terciar financohet nga Ministria dhe përfshijnë mbi 72% të buxhetit të alokuar për shëndetësi.

Në vitin 2013 vlera e shpenzimeve shëndetësore për kokë banori ishte 135 euro / banor ose 4.5% të GDP-së.

Burimet njerëzore

Stafi i përgjithshëm në kujdesin parësor shëndetësor (KSHP)(2013) është 5,453 veta, prej tyre personel mjekësor 4.579, ndërsa staf jo-mjekësor 842 veta.

Stafi mjekësor i kujdesit parësor shëndetësor (KSHP) (gjithsej 4.579) përbëhet nga 1,326 mjekë, prej të cilëve 476 janë specialistë në mjekësinë familjare; si dhe nga 3.050 infermierë, nga të cilët 2.118 janë infermierë të trajnuar familjarë.

Personeli mjekësor i kujdesit dytësor shëndetësor (KDSH) dhe kujdesit tretësor shëndetësor (KTSh) përbëhet nga 1,441 mjekë dhe 3,966 infermierë.

Në përgjithësi, në të tri nivelet në institucionet shëndetësore publike punojnë gjithsej 2,767 mjekë dhe 7,016 infermiere, ndërsa 1.806 mjekë dhe 1.666 infermierë janë të punësuar në institucionet shëndetësore private.

Treguesit demografikë dhe socio-ekonomikë

Kosova përbëhet nga një popullatë që është më e reja në Evropë, me një moshë mesatare prej rreth 30 vjet (rreth 50% e popullsisë është nën 28.2 vjeç). Pavarësisht nga kjo popullatë e re, Kosova megjithatë është duke u ndikuar në mënyrë të pashmangshme nga tendenca globale e moshimit e karakterizuar nga një reduktim i konsiderueshëm i rritjes së popullsisë nga 27% në 1981 në 9% në vitin 2007. Kjo është reflektuar në një rritje të qëndrueshme në përqindjen e njerëzve të moshuar gjatë viteve. Kështu, të dhënat zyrtare tregojnë se nga viti 2003 në 2009 përqindja e njerëzve të moshës ≤ 15 vjeç u ulë rreth pesë për qind (nga 33% në 28%), së bashku me një rritje në proporcionin e individëve të moshës ≥ 65 vjet nga 4.5 % (në vitin 1981) në 6.7% (në vitin 2011). Trendi i moshimit mund t'i atribuohet uljes së niveleve të fertilitetit, një jetëgjatësie më të lartë dhe emigrimit të popullatës më të re të aftë për punë.

Sipas të dhënave të ASK në vitin 2011, 29.7% e popullsisë jetonin nën kufirin e varfërisë (€ 1.72/ ditë/të rritur) dhe 10.2% nën kufirin e varfërisë ekstreme (1.2 euro / ditë / të rritur).

Profili shëndetësor

Jetëgjatësia mesatare në Kosovë në vitin 2011 ishte 76.7 vjet, përkatësisht 74.1 vjet për meshkuj dhe 79.4 për femra.

Krahas shkallës së lartë të vdekshmërisë foshnjore (17.1 për 100 lindje të gjalla në vitin 2011), shkallës së lartë të vdekshmërisë së fëmijëve, si dhe shkallës së lartë të vdekshmërisë së nënës (7.2 për 100.000 në vitin 2011), Kosova ka norma të larta të vdekjeve nga lëndimet dhe shkaqet e tjera të

jashtme të vdekjes, si dhe në shkallë më të vogël vdekje nga sëmundjet kardiovaskulare dhe kanceri. Nga ana tjetër, vdekshmëria nga insultet cerebellare, pavarësisht nga mungesa e raporteve zyrtare, në Kosovë është poashtu dukshëm më e lartë se në vendet anëtare të BE-së një situatë e ngjashme me shumë vende në Ballkanin Perëndimor.

Në një studim të paradokohshëm me popullatën e moshuar në Kosovë, diku rreth 83% e të moshuarve raportuan të paktën një sëmundje kronike (63% sëmundje kardiovaskulare), dhe 45% kishin të paktën dy sëmundje kronike. Qasja e kufizuar në kujdesin mjekësor ishte një parashikues i rëndësishëm dhe i qëndrueshëm i sëmundshmërisë dhe i multimorbiditetit kronik ndër të moshuarit në Kosovë. Shumica dërmuese e individëve të moshuar, të cilët nuk kishin akses në kujdesin mjekësor (pothuajse 90%) indikuan se arsyeja kryesore për këtë ishin pengesat financiare ekonomike. Rezultatet e pafavorshme shëndetësore në popullsinë e rritur, duke përfshirë edhe njerëzit e moshuar, janë dukshëm një pasqyrim i situatës jo të volitshme socio-ekonomike në Kosovë përkundër përpjekjeve të reformave të vazhdueshme në sektorin e shëndetësisë.

Faktorët e stilit të jetesës/faktorët e riskut shëndetësor

Në Kosovë, sëmundjet jo-ngjitëse të lidhura me moshën dhe stilin e jetesës janë në rritje, sidomos kanceri, sëmundjet kardiovaskulare dhe diabeti-sëmundje të cilat janë zakonisht të lidhura me një konsum të lartë të duhanit, alkoolit dhe yndyrës së saturuar. Prevalenca e pirjes së duhanit në Kosovë (gjithsej: 28.4%) është më e ulët se në vende të tjera të Ballkanit Perëndimor duke përfshirë edhe Shqipërinë fqinje. Në mënyrë të ngjashme, konsumimi i tepruar i alkoolit dhe pirja e lehtë e tij janë shumë më të ulëta sesa në Shqipëri. Nga ana tjetër, zakonet dietike jo të shëndetshme duke përfshirë marrjen e ulët të frutave të freskëta dhe perimeve konsiderohet të jenë më të përhapura në popullsinë e Kosovës në krahasim me dietën disi mesdhetare të Shqipërisë. Së bashku me modelet dietike jo të shëndetshme dhe nivelet e ulëta të aktivitetit fizik, kushtet e pafavorshme socio-ekonomike dhe psiko-sociale konsiderohen si shtytës të rëndësishëm të morbiditetit të tepërt dhe vdekshmërisë nga sëmundjet kronike në Kosovë duke përfshirë diabetin, sëmundjet kardiovaskulare dhe sëmundjet e tjera kronike. Përdorimi i drogës në mesin e nxënësve në Kosovë është 7%, që është më e ulët se mesatarja e ESPAD prej 20%. Midis viteve 1986

dhe 2015 Kosova ka pasur 100 raste me HIV/AIDS (54 raste të AIDS, 46 raste me HIV), me gjithsej 41 vdekje të regjistruara.

Reformat e kujdesit shëndetësor

Sektori i shëndetësisë - një prioritet i qeverisë

Në dhjetëvjetëshin e fundit, sektori i shëndetësisë, sikur për herë të parë ka nisur të vendoset si një prioritet kyç në Programin e Qeverisë së Kosovës, duke synuar përmirësimin e indikatorëve shëndetësor (të pafavorshëm në raport me rajonin dhe Evropën për një kohë të gjatë); si dhe përmirësimin e infrastrukturës shëndetësore, në përputhje me tendencat teknologjike, dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Zbatimi i reformave është bazuar në pakon e miratuar të ligjeve të sektorit të shëndetësisë, që kanë të bëjnë me riorganizimin e tre niveleve të sektorit të shëndetësisë në Kosovë. Ligji i rishikuar i shëndetësisë i miratuar në vitin 2012, ka themeluar Shërbimin Spitalor Klinik Universitar (SHSKUK), si një institucion që integron në një strukturë të përbashkët kujdesin shëndetësor dytësor dhe terciar. Kjo qasje është ndërmarrë me qëllim të ofrimit të kujdesit shëndetësor të integruar për qytetarët e Kosovës. Poashtu, Ligji për Sigurimin Shëndetësor (2014), krijon Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, si një autoritet që do të sigurojë rregullimin e financimit të sektorit shëndetësor. Në këtë aspekt, legjislacioni plotësues tashmë është miratuar dhe janë bërë hapa të rëndësishëm për funksionimin e Fondit të Sigurimeve Shëndetësore. Hapi tjetër që synohet të arrihet deri në vitin në vijim (2019) është zbatimi i skemës së sigurimeve shëndetësore.

Strategjia e Sektorit Shëndetësor (SSSh)

Strategjia e Sektorit Shëndetësor e Qeverisë së Kosovës synon të ruajë shëndetin, të promovojë mënyra të shëndetshme të jetesës dhe të ofrojë shërbime cilësore, të sigurta, lehtësisht të arritshme, të barabarta, pa rrezik financiar dhe shërbime kosto efektive.

Objektivat e saj strategjike përfshijnë:

- 1) mirëmbajtjen dhe përparimin e shëndetit;
- 2) sigurimin e financimit të qëndrueshëm të kujdesit shëndetësor; dhe
- 3) riorganizimin e sektorit të shëndetësisë.

Reforma e sistemit shëndetësor synon të përmirësojë cilësinë e shërbimeve dhe të forcojë infrastrukturën e kujdesit parësor dhe sistemit të informacionit shëndetësor.

Analiza e ofruar në Strategjinë e Sektorit Shëndetësor (SSSh) tregon se Republika e Kosovës ka një rrjet të institucioneve shëndetësore me personel profesionistësh shëndetësorë të përkushtuar, të cilët ofrojnë kujdes shëndetësor bazë të krahasueshëm me rajonin duke përfshirë edhe një mbulim të lartë të imunizimit. SSSH, por edhe analizat më të fundit, theksojnë se Kosova, si një nga vendet e varfëra në Evropë, ka nevojë të adresojë një numër sfidash fundamentale para se sektori shëndetësor të bëhet një sistem gjithëpërfshirës i shërbimeve parandaluese, diagnostike dhe trajtuese të përshtatura me nevojat e popullsisë dhe mbështetjen e qytetarëve për të pasur një status shëndetësor të krahasueshëm me popullsinë e BE-së.

Me popullatën më të re në Evropë, sistemi i kujdesit shëndetësor në Kosovë duhet të jetë në gjendje t'i përgjigjet një kërkesë të lartë për shëndetin riprodhues dhe shërbimeve të planifikimit familjar. Prandaj, plani aktual i veprimit i Ministrisë së Shëndetësisë i kushton vëmendje të veçantë përmirësimit të shëndetit të nënës dhe fëmijës në një nivel të krahasueshëm me Bashkimin Europian, dhe kështu edhe arritjes së Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit.

Kosova ballafaqohet me sfidën për të adresuar nevojat e një sistemi ende të paefektshëm shëndetësor të karakterizuar nga mungesa e personelit të trajnuar, pabarazitë në shpërndarjen e forcës shëndetësore që çon në variacione në aksesin ndaj kujdesit parësor, korrupsionin dhe pagesat informale, si dhe indikatorët shëndetësor jo të volitshëm të fëmijëve dhe të të rriturve. Në këtë kontekst, reformimi i vazhdueshëm i sektorit të shëndetësisë ka sjellë një konfiguracion kompleks të palëve të interesit që veprojnë në sistemin shëndetësor. Nën këto kushte, vëmendje e vogël i kushtohet komunitetit në rritje të individëve të cënueshëm dhe të marginalizuar në Kosovë, siç janë për shembull popullata e moshuar, që në kombinim me papërshtatshmërinë e burimeve financiare, pasigurinë ekonomike dhe zhvillimin e paqartë dhe të paqëndrueshëm të sektorit të shëndetësisë përbën një pengesë serioze për këto nëngrupe popullatash për të siguruar qasje në kujdesin e nevojshëm mjekësor.

Financimi i kujdesit shëndetësor

Miratimi i Ligjit të ri të shëndetësisë në dhjetor 2012 nga Kuvendi i Kosovës kishte për qëllim kalimin nga një sistem i centralizuar i kujdesit shëndetësor i krijuar nën kushtet e emergjencës së periudhës së pasluftës drejt një sistemi bashkëkohor të kujdesit shëndetësor me një ndarje të qartë blerës-ofrues bazuar në një transparencë dhe llogaridhënie të ofruesve të kujdesit shëndetësor dhe kontraktorëve të tyre. Kjo reformë, që synon ndryshime të rëndësishme brenda sektorit të shëndetësisë në Kosovë, përbëhet nga dy shtylla kryesore: (i) riorganizimi strukturor dhe funksional i sistemit të kujdesit shëndetësor përmes themelimit të Shërbimit Shëndetësor Klinik Universitar të Kosovës (një ndërmarrje publike autonome dhe jofitimprurëse në nivel qendror të sektorit të kujdesit shëndetësor), dhe; (ii) themelimi i sistemit të sigurimeve shëndetësore publike me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore si organi kryesor i tij.

Në çdo rast, parimet bazë të reformës aktuale të kujdesit shëndetësor në Kosovë përfshijnë parimet e mëposhtme: mbulimi universal, barazia, transparenca, qëndrueshmëria, llogaridhënia, përfshirja, solidariteti, reciprociteti dhe pjesëmarrja.

Riorganizimi strukturor dhe funksional i sistemit të përgjithshëm të kujdesit shëndetësor paraqet një proces mjaft të vështirë dhe kompleks që përfshin një proces të njëkohshëm të ndarjes dhënësi - blerësi nëpërmjet riorganizimit të brendshëm të sistemit.

Përfundimisht, hapi kryesor i reformës përbëhet nga miratimi i Ligjit për Sigurimin Shëndetësor (2014) dhe krijimi për herë të parë të sistemit të sigurimeve shëndetësore publike me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore si organi kryesor i tij. Objektivi kryesor i Ligjit për Sigurimin Shëndetësor është për të siguruar financim optimal dhe të qëndrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Përfundim

Kosova ka kaluar nëpër një tranzicion të shpejtë që përfshin ndryshime të mëdha politike, sociale dhe ekonomike të cilat janë të lidhura me efekte shëndetësore në popullatë. Sfidat në sektorin e shëndetësisë janë evidente siç është përmirësimi i indikatorëve shëndetësor dhe efikasiteti i sistemit

shëndetësor. Kjo nënkupton adresimin e duhur të shpenzimeve të ulëta të shëndetit publik, pagesave ende të larta nga xhepi; nivelin e ulët të përdorimit të portës së kujdesit parësor, zbatimin e Ligjit për sigurime shëndetësore, sistemin e informimit shëndetësor, menaxhimin strategjik, përmirësimin dhe kontrollin e cilësisë dhe sistemet e raportimit, duke përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e udhëzimeve dhe protokolleve klinike.

Poashtu, evidenca aktuale në lidhje me përmasën e saktë të sëmundshmërisë akute dhe kronike dhe shpërndarjen e faktorëve të rrezikut në popullsinë e Kosovës është e pakët për shkak të punës së kufizuar hulumtuese që synon eksplorimin e efekteve shëndetësore të tranzicionit dhe variacionet në rezultatet e shëndetit të popullatës. Nga kjo pikëpamje, ngjashëm me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, ekziston një nevojë e dukshme për të nxitur financimin e kërkimit dhe sidomos për të zhvilluar dhe forcuar kapacitetet kërkimore në Kosovë.

Në përfundim, dhjetë vjet pas Deklaratës së Pavarësisë, Kosova vazhdon të përballet me një tranzicion ende të vështirë socio-ekonomik dhe politik dhe është gjithashtu duke drejtuar të gjitha energjitë dhe përpjekjet për të marrë njohje të plotë ndërkombëtare. Gjithsesi, në këtë kontekst duhet të merret në konsideratë shfrytëzimi sa më i volitshëm dhe efikas i aseteve dhe mundësive potenciale të veçanta për Kosovën, të tilla si: potencialet e njerëzve për të gjeneruar ndërmarrësi dhe për të punuar së bashku; popullata e re dhe dinamike me profil relativisht të mirë shëndetësor dhe të riskut; partneritetet ekzistuese dhe bashkëpunimet për të mbështetur ndryshimet transformuese; si dhe roli i Diasporës së Kosovës për të lehtësuar nivelet e varfërisë (nëpërmjet investimeve dhe remitancave).

Referencat:

Jerliu N, et al. Public health in Kosovo after five difficult years of independence (Review article). SEEJPH 2013, posted: 31 October 2013. DOI 10.12908/SEEJPH- 2013-02.

Assembly of the Republic of Kosovo. Law Nr. 04/L-125 on Health, Prishtina, Kosovo, 2012.

Assembly of the Republic of Kosovo. Law Nr. 04/L -249 on Health Insurance, Prishtina, Kosovo, 2014.

Kosovo Agency of Statistics. Kosovo in Figures 2017. Prishtina, Kosovo, 2018.

International Labour Organization. Profile of the social security system in Kosovo (within the meaning of UNSC Resolution 1244 [1999]). 2010.

Statistical Office of Kosovo. Demographic, Social and Reproductive Health Survey in Kosovo, November 2009. Pristina, Kosovo; 2011.

The World Bank. Europe and Central Asia Region. Poverty Reduction and Economic Management Unit. Statistical Office of Kosovo. Consumption Poverty in the Republic of Kosovo, in 2009. Western Balkans Programmatic Poverty Assessment. 2011.

Jerliu N, Toçi E, Burazeri G, Ramadani N, Brand H. Socioeconomic conditions of elderly people in Kosovo: a cross-sectional study. BMC Public Health 2012;12:512.

Jerliu N, Toçi E, Burazeri G, Ramadani N, Brand H. Prevalence and socioeconomic correlates of chronic morbidity among elderly people in Kosovo: a population-based survey. BMC Geriatr 2013;13:22.

Percival V, Sondorp E. A case study of health sector reform in Kosovo. Conflict and Health 2010;4:7.

Institute of Statistics, Institute of Public Health [Albania] and IFC Macro. Albania Demographic and Health Survey 2008-09. Tirana, Albania, 2010.

Ministry of Health, Kosovo. Health Sector Strategy 2017-2021. Prishtina, Kosovo, 2016.

Prof. Ass. Dr. Naim Jerliu
Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës
& Fakulteti i Mjekësisë, Universiteti i Prishtinës

ROLAND NIKLAUS

E DREJTA E PRONËS DHE NOTERIA NË KOSOVËN E PAVARUR

Olivier Meuwly (mbi bazën e konferencës së paraqitur nga Roland Niklaus, noter dhe bashkëhartues i ligjit për noterinë në Kosovë, nën mandatin e OKB dhe SDC)

Përzgjedhja e guximshme për një noteri liberale

Ndryshe nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe zonën e saj të ndikimit, që krijuan një noteri të ushtruar nga shërbyesit civilë, nën urdhërat e shtetit që e kishte edhe ngarkesën financiare, Jugosllavia nuk kishte noterë. Prandaj, edhe mund të jemi mirënjohës për guximin e Kombeve të Bashkuara të cilët në kuadër të lëvizjeve të reformave juridike të ndërmarra nga Këshilli i Evropës në Evropën qendrore pas rënies së murit të Berlinit, vendosën që krijimi i një noterie ishte një element qendror në vendosjen e shtetit të së drejtës në Kosovë.

Sfidat për të kapërcyer ishin përpjekjet për rindërtimin e një territori të prekur rëndë nga luftimet dhe bombardimet. Duhej punuar në një kontekst institucionalisht të trazuar, qoftë për shkak se trashëgimia e së kaluarës ishte e rëndë, por edhe për shkak të heterogjenitetit të shteteve që kujdeseshin pas luftës për të ardhmën e Kosovës së çliruar më 1999. Një « risajim » të shtetit të së drejtës u jetësua mbi bazën e ligjeve të sjellur, shpeshherë, me tradita të ndryshme juridike (SHBA, Britani e Madhe, Francë, Gjermani). Një kod civil u përgatit megjithatë me sukses. Nga kjo kornizë u ridefinua një e drejtë e pronësisë në përputhje me doket dhe zakonet lokale, por edhe me parimet e shtetit të së drejtës. Ishte një kusht sine qua non për përfshirjen e Kosovës në radhët e shteteve të qëndrueshme demokratike...

Skicimi i një strukture juridike të një shteti është një operacion kompleks në vete. Sidomos kur ai mbështetet në një kulturë juridike, dukshëm burim i komunizmit, të cilin nuk e duan aktorët kombëtar ose ndërkombëtar dhe që duhet ndryshuar rrënjësisht. Por vendosja e bazës institucionale nuk mjafton: duhet ruajtur frymën e qëllimit dhe koherencës së kantierëve legjislativ të nisura nga autoritetet e reja në bashkëpunim me fuqitë «mbrojtëse», duhet siguruar mjaftueshmërinë e metodave të punës mbi nevojat e momentit, duhet mbështetur në një staf të besueshëm. Si i tillë,

shembulli i ligjit për noterinë është një rast studimi magjepsës. Duhej së pari të përcaktohej lloji i noterisë që duhej i preferuar: përparësitë që sjellë një noteri liberale për shoqërinë civile (lehtësimi i lëndëve gjyqësore, braktisja e detyrave të drejtësisë jokontestimore, vendosja e marrëdhënieve juridike të sigurta midis qytetarëve) ishin ato që u përzgjedhën me gjithë rrezikun e dështimit dhe, kjo është e rëndësishme, koston e lartë të një ndërmarrje e cila sigurisht se do të zgjaste. Por nëse krijimi i një legjislacioni noterial është një gjë, identifikimi i personave të aftë për t'u bërë noterët e parë të një shteti është një gjë tjetër. Kjo ishte një nga çelësat e suksesit të punës sonë.

Përmes një emaili të datës 10 gusht 2004, Departamenti i Drejtësisë, njësia e çështjeve juridike dhe politike (Legal Policy Unit) të Misionit të Kombeve të Bashkuara (UNMIK), kontaktoi Roland Niklaus, njërin nga akterët ndërkombëtar që merret me noteri, nëpërmjet Institutit ndërkombëtar për studime të larta noteriale (I-H-N). Kjo organizatë ka selinë e saj në Zvicër dhe është krijuar më 1998 për t'i mbështetur noterët e rinj të Evropës Qendrore dhe Lindore. Qëllimi i këtij kontakti ishte të sigurohet ndihma për krijimin e sistemit noterial të bazuar në një skemë liberale, të aftë për t'i rimarrë funksionet noteriale të ushtruara deri atëherë nga gjykatësit. Si një institucion fleksibil dhe i gatshëm për të angazhuar në një afat të shkurtër një ekipë noterësh me përvojë, IHN pranoi kërkesën. Me përvojë të gjatë, ai mori mandatin për ta përgatitur një ligj noterial të modelit latin, të strukturuar mbi parimet themelore të Unionin ndërkombëtar të noterëve latin (UINL).

Krijimi i së drejtës noteriale

Mandati i UNMIK-ut i lëshuar zyrtarisht në fund të vitit 2004 synonte qëllime si në vijim. Në bashkëpunim më këtë të fundit, IHN duhej së pari të propozonte një skemë të ligjit noterial, e pastaj ta stërhollojë në bashkëpunim më përfaqësuesit e tri pushteteve të shtetit të ri kosovar. Ligji është miratuar nga kuvendi i Kosovës më 17 tetor 2008. Zvicra është angazhuar sidomos shumë herët në fazën e dytë të projektit, nëpërmjet Drejtorisë për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) të Departamentit federal për punë të jashtme. Arsyeja pse Zvicra interesohej në ndërtimin e shpejtë dhe të sigurt të një shteti të së drejtës ishte e qartë. Zvicra ka mirëpritur një numër shumë të madh refugjatësh, që iknin nga lufta dhe persekutimet dhe

që kishin të njerëz të afërm të cilët punonin që një kohë të gjatë në Zvicër, edhe si punëtorë sezonal. Ishte pra e domosdoshme që të vendosej një sistem juridik i besueshëm, që do të garantonte një zhvillim të vendit që do të ishte i prirur ta nxis kthimin e kosovarëve në shtëpitë e tyre, por edhe ta nxis përforcimin e sigurisë juridike për kosovarët e mbetur në Zvicër, si dhe për dokumentet e lëshuara në Kosovë, si vërtetimet që personi është gjallë të kërkuara nga kompanitë e sigurimeve publike ose private.

Nën mbikëqyrjen e përfaqësuesit të saj në Kosovë dhe në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara, SDC nënshkroi kështu një «Memorandum Mirëkuptimi» me Ministrinë e Drejtësisë të Kosovës, që trajtonin hartimin e rregulloreve shtesë, trajnimin e kandidatëve për noterë, hapjen e një zyre testuese noteriale dhe në fund, ndërtimin e një sistemi të sigurt për provimet. Mbi këtë bazë edhe u caktuan qëllimet konkrete vijuese : 1) duhej krijuar legjislacioni sekondar i ligjit për noterinë, si dhe harmonizimi i legjislacionit noterial me ligjet e tjera; 2) duhej vendosur përzgjedhja e kandidatëve dhe një koncept trajnimi; 3) një grup i parë i noterëve do të duhej sapo të kishte mundësi të betohej pasi t'i jepnin provimet; 4) administrata shtetërore dhe publike duhej të jetë e informuara për rolin dhe funksionet e noterëve me të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion.

Meritë e madhe i takon SDC-së që e mbështeti pa asnjë kusht krijimin e së drejtës noteriale liberale, me të gjitha elementet e tij dhe pa dashur t'ia imponojë Kosovës një sistem zviceran. Ajo parapëlqeu një sistem të pastër, të qartë dhe të bazuar mbi parimet themelore të Unionit Ndërkombëtar të Noterisë.

Jetësimi i një plani ambicioz udhëzues

Detyrimi i parë: përzgjedhja e kandidatëve. Kjo përzgjedhje i është besuar Ministrisë së Drejtësisë, nën mbikëqyrjen ndërkombëtare. Puna nuk ishte e lehtë: mbi çfarë kriterë mund të përzgjedheshin me objektivitet juristë tashmë të diplomuar dhe të gatshëm ta ndjeknin një trajnim për një profesion të panjohur për ata deri atëherë? Si mund të përcaktohej aftësia e një kandidati? Si të shmangeshin diskriminimet dhe favorizimet? Pas publikimit në gazetën zyrtare dhe nëpër media, më shumë se 600 kandidatë aplikuan në ministri! Në fund, procedura e përzgjedhjes rezultoi me 211 kandidatë për trajnim. Kjo procedurë është kryer plotësisht nga Ministria e Drejtësisë dhe nga shërbimi i saj juridik, pa asnjë ndërhyrje të IHN-së. Trajnimet u

zhvilluan në ndërtesën e Entit të statistikave. IHN krijoi 9 module trajnimi, të cilat mbulonin tërësinë e aspekteve të profesionit noterial, si në shqip ashtu në serbisht. Secili modul ligjërohej përgjatë shumë orëve, para se të shpërndahej në formë të shtypur: kjo e nxiste dëgjimin e kandidatëve!

Provimet u mbajtën në Akademinë e Policisë në Vushtri, mes qershorit 2010 dhe nëntorit 2011 (edhe për afatin e përsëritjeve), nën mbikëqyrjen e rreth dhjetë pjesëtarëve të policisë. Të organizuar me përpikëri të madhe, qoftë për nga aspekti i sigurisë ashtu edhe për aspektin shkencor, provimet ishin pa dyshim sfida më e madhe më të cilën janë përballur ekspertët. Një komision i përbërë nga juristë kosovarë (gjykatës, avokatë, prokurorë dhe ligjërues universitar me përvojë) e ishte përgjegjëse për të, me ndihmën e ekspertëve të huaj.

Ishte e nevojshme të kontrollohej saktësisht tërësia e procedurës. Vërtetë, çfarëdo lëshimi do ta njolloshte reputacionin e notarisë para lindjes së tij! Për t'i përgatitur temat e provimit, komisioni është mbledhur në një sallë të mbyllur, pa mjete të komunikimit me jashtë. Në fund të punës, tërësia e shënimeve të anëtarëve të komisionit është djegur: anëtarët ishin mbledhur në një piceri dhe furra ishte e dobishme... Të përpiluara dhe të përkthyer aty për aty - me vështirësitë lidhur me problemet e njohura të gjuhës shqipe, dhjetë tema janë mbajtur për tërheqjen e shortit të temave që do të ishin objekt i provimit të vërtetë. Ata janë ruajtur të mbyllur në kasafortën e Ambasadës së Zvicrës dhe janë sjellur në sallë ditën e provimit. Secili kandidat kishte dorëzuar një foto të tij në momentin e regjistrimit me numrin e tij rendor. Pas dorëzimit në hyrje të celularit, llap-topit dhe shënimeve të tij, kandidati ulej në një tavolinë pune personale me numrin e fotografisë dhe letrën zyrtare për shënime e cila identifikohet me një kod numëror. Kompjuteri i Roland Niklaus ishte në fakt kasaforta: vetëm ai i kishte të dhënat e kandidatëve.

Një ligj i thjeshtë dhe i qartë

Ligji hyri në fuqi në prill 2012, me betimin e tridhjetë e shtatë noterëve të parë kosovar. Ligji është i bazuar në dallimin historik midis akteve «en minute» dhe akteve «en brevet». Kjo me një qëllim gati se pedagogjik për ta bërë mirë nismën midis kontratave të «vërteta» dhe akteve «të «vogla» rutinore. Ankesat ndaj noterëve mund të bëhen nga Ministria e drejtësisë ose nga vetë klientët. Ligji për Noterinë (LN) është klasik dhe konciz (77

nene): Law No 03/L-10 on Notary. Ai ekziston në shqip, serbisht dhe anglisht. Ai mundëson qasje në profesion të rezervuar për juristët që munden të justifikojnë një stazh praktik në një zyre noteri, e pastaj dhënien e provimit me shkrim (përpilim të akteve) dhe me gojë. Që në fillim, ekspertët zviceran kishin heq dorë nga eksportimi i sistemit të tyre për shkak të diversitetit të tij të jashtëzakonshëm: Secili kanton zviceran ka ligjin e tij sa i përket kompetencave në të drejtën noteriale. Pra, ata hartuan një ligj modern, me nene të shkurtëra, ndryshe nga ligjet e modelit sovjetik.

Ligji për Noterinë është i plotësuar nga një legjislacion të quajtur sekondar, me formën e dekreteve ministrore (udhëzime administrative), gjithsej dhjetë dhe që kanë të bëjnë me: kodin e deontologjisë, tarifat (thelbësore sepse duhej siguruar të ardhura të mjaftueshme për noterët për ta penguar rrezikun e korrupsionit, pa i bërë shumë të shtrenjta shërbimet), procedurën disiplinore, provimet, numrin dhe vendin e studimeve, depozitat e letrave me vlerë, konkurset, përpilimin e akteve, vulën e noterit, regjistrat. Pa harruar rregulloren lidhur me Odën e Noterëve, e themeluar me 14 prill 2012 dhe që ka për detyrë mbikëqyrjen e profesionit. Në mesin e ligjeve të tjera të rëndësishme për praktikën e noterisë dhe që është dashur të krijohet plotësisht, të përmendim ligjin për regjistrin e pronës: organizimin e një kadastrë cilësor është në të vërtetë i pandashëm nga një organizim i qartë të së drejtës së pronësisë.

Pasi u pranuan si noterë të pavarur, të përzgjedhurit fatlum u deshtën ta mësojnë profesionin e tyre në realitetin e përditshëm. Çelësi i organizimit të profesionit është planifikimi dhe ekspertët kanë kaluar shumë orë duke ia shpjeguar kandidatëve kuptimin e këtij koncepti: dallimin e urgjencës nga e rëndësishmja me të gjitha variacionet që burojnë nga ky binom. Një çështje urgjente nuk është doemos e rëndësishme dhe anasjelltas... Një ditë e zakonshme e një noteri në Prishtinë artikullohet kështu mbi këtë model:

8 h. 30: ardhja në zyrë me sekretarët

8 h. 45: takim mbi agjendën ditore

9 h. 00: hapja e zyrës për publikun. Ardhja e palëve të para pa termin të caktuar, për legalizimin e dokumenteve, vërtetimin e kopjeve, t'i bëjë të vlefshëm autorizimet për ngasjen e automjeteve për shembull.

9 h. 30 : palët me termin të caktuar për një hipotekë; si dhe vazhdim i pranimit të palëve pa termin të caktuar nga sekretariati

11 h. 30: palët me termin të caktuar për një kontratë shitblerje të një banese

12 h. 00 - 13 h. 00: dreka me kolegët për të diskutuar mbi punën

13 h. 00: ripranim i palëve pa termin të caktuar

13 h. 30: palë me termin të caktuar për një trashëgimi; si dhe vazhdim i pranimit të palëve pa termin të caktuar nga sekretariati

15 h. 30: palë me termin të caktuar për një këshillë lidhur themelimin e Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K)

16 h. 00: mbyllja e zyrës për palët; regjistrimi dhe klasifikimi i lëndëve të ditës, përgatitja për lëndët e nesërme

17 h. 00: mbyllja e zyrës

Përfundim

Autorët e Ligjit për Noterinë kanë mundur të llogarisin në mbështetjen e tre ministrave të drejtësisë që janë zëvendësuar gjatë viteve të para të programit. Por, ardhja e një ministre të re të drejtësisë në vitin 2015 ndryshoi rrjedhën, meqë ajo shprehu shpejtë dëshirën për ta ndryshuar ligjin. Nismë kjo që mund ta gjykojmë si të papranueshme, ngaqë thjeshtëson kushtet për qasje në profesion. Ekspertët nuk kanë pasur tutje kontakte me ministrin e ri pas zgjedhjeve të fundit, por Kuvendi është ftuar për ndryshimin e Ligjit për noterinë.

Më 2018 kemi 55 noterë burra dhe 18 gra. Deri më 2013, 31.255 akte en minute ishin përpiluar, kundrejt 111.971 më 2016. Kishim 266.543 akte en brevet më 2013, kundrejt 366.770 tre vjet më vonë. Unioni Ndërkombëtar i Noterisë ka mirënjohur përpjekjet e bëra nga noteria e re e Kosovës duke e pranuar këtë shtet si anëtarin e 86 të kësaj organizate, gjatë asamblesë së saj të përgjithshme në Lima (Peru) në tetor 2013.

Burimi: Michel Merlotti, Notaries in Kosovo. Success for a Swiss model of cooperation 2008-2017, DDC, Berne, 2017.

SAFET GËRXHALIU

KOSOVA KA NEVOJË PËR EKONOMI TË DIJES

10 Vjet pavarësi e Republikës së Kosovës - Simpoziumi në Zvicër

Vuajtjeve të së kaluarës së qytetarëve të Kosovës ju erdhi fundi që nga Qershori i vitit 1999 kur u vulos ky fat i pavarësisë së shtetit tonë me 17 shkurt 2008, me shpalljen e pavarësisë së Republikës së Kosovës. Një realitet që e vulosi një ëndërr të arritur të popullit tonë pas një të kaluare mjaft të hidhur. Një realitet të cilin e pranuan shumë shtete demokratike, Evropiane dhe Botërore, që duhet të ishte edhe një motiv shtesë për t'u forcuar dhe shpejtuar procesin e shtetndërtimit të Republikës së Kosovës.

Ëndrra e kahmotshme është realizuar, por lind pyetja a mund të jetohet në ëndrra dhe duke tentuar për ta hijeshuar të kaluarën e jo të ndërtojme ardhmërinë. Në këtë drejtim kam drojën se auforia e tepruar i kushtoi Kosovës në ngadalësim të proceseve, në veçanti euforia nacionale e përcjellur me patriotizëm folklorik që e kaploi masën dhe nuk gjetëm kurajë për ta prekur substancën dhe satisfaksionin e gjenim te forma. Nëse jemi të orientuar drejtë ardhmërisë si shteti më i ri në Evropë, atëherë prioritet duhet të ishte dhe duhet të jetë zhvillimi ekonomik, si garancë e stabilitetit politik, social, përshpejtues i procesit integruar si dhe përmirësues i perceptimit dhe imazhit të Kosovës.

Objektivat strategjike të Kosovës duhet të ishin ato që fillojnë me germën "E", në gjuhën angleze: E - Europe, E - education, E - economy, E - environment dhe E- experience, por që të arrihen këto objektivat duhet të jemi të orientuar në edukim cilësor dhe në sundim të rendit dhe të ligjit, si emëruesi i përbashkët i zgjidhjes së sfidave të parashtruara. Besoj që pikërisht këto dy fusha kanë qenë dështimi më i madh i Kosovës së pasluftës, nga i cili dështim u gjeneruan efekte negative në formë duale, në aspektin intern dhe ekstern.

Në aspektin intern si pasojë e dështimit në këto dy shtylla të shtetit kemi politizim të skajshëm të administratës publike, politizim të ndërmarrjeve publike, meritokraci e bazuar në antivlerë dhe përkatësi politike, një korrupsion që në momentet e caktuara mund të matet me efektet e një inflacioni gallopan dhe e tërë kjo reflekton në humbjen e shpresës së të rinjëve drejtë ardhmërisë në këtë vend. Është një fenomen që duhet cekur ku llogaritet se sëmundja aktuale e këtij shekulli është "stresi", por në

Kosovë manifestohet në dukuri më shqetësuese që e kaplon masën dhe ai është “ankthi”.

Në aspektin ekstern është krijuar një perceptim negativ rreth Kosovës që në masë të madhe ndikon në imazhin e saj dhe kur krejt kësaj i shtohet edhe fakti tjetër që me qëllim apo pa qëllim anashkalohet kapitali më substancial që ka Kosova jashtë e që është diaspora jonë, atëherë nuk duhet të na habitë një bindje e tillë negative rreth Kosovës.

Është shkurti i 2018 një vit ku agjenda politike ishte dominante në realitetin e krijuar në Republikën e Kosovës së pasluftës. Një agjendë politike e cila shumë më tepër aktualizohet si arsytim për dështimet e të kaluarës sesa një vizion orientues drejtë ardhmërisë sonë.

Një politizim i cili e ka kapluar shoqërinë kosovare i cili ka gjeneruar një ç’orientim në masë dhe kur masa politizohet atëherë duhet mund dhe angazhim për një riorientim pozitiv. Në këtë drejtim si pasojë e një politizimi të tillë tentohet në masë të madhe sundimi i rendit dhe i ligjit si emërues i përbashkët i zgjidhjes së problemeve të grumbulluara nga e kaluara dhe kuptohet në një vend ku kemi mangësi ligjore e para që goditet dhe pëson është edukimi, vazhdohet me ekonominë, pason shëndetësia dhe lulëzon korrupsioni. Një situatë e tillë e ndërtuar në baza politike sa i përket punësimit ku kriter nuk është dija, por përkatësia politike dhe meritokracia partiake është rrugë e garantuar për dështim edhe në aspektin ndërkombëtar e në veçanti kur ka të bëjë me perceptimin dhe imazhin e Kosovës.

Jemi në një situatë ku Kosova në aspektin ekonomik është në pozitë shumë të palakmueshme, sidomos pas shpalljes së pavarësisë së vendit dhe për një situatë të tillë nuk duhet fajësuar Brukseli, Uashingtoni, Parisi e Londra, por faji është tek lidërshipi vendor ku vetëm antivlerën e promovon si vlerë dhe vlerën si të padëshiruar për interesa të ngushta partiake dhe klanore.

Një popull i edukuar është lehtë për tu menaxhuar, por është shumë vështirë për t’u okupuar. Është një thënie e mendimtarëve të mëdhenj që duhet të jetë në target të Kosovës sepse edhe në vitet më të errta arsimimi në Kosovë nuk ka qenë në pozitë më të vështirë dhe më të palakmueshme. Një populli që i’a shkatërroi arsimin dhe shëndetësinë si dy shtylla të funksionimit të shtetit normal, paramendojeni çfarë ardhmërie me plot sfida e pret.

Kam drojën që humbja e energjisë në tentim të zbulimit të së kaluarës dhe jo në ndërtim të ardhmërisë e bazuar në edukim, zhvillim ekonomik, shëndetësi, sundim të rendit dhe ligjit do të jetë një ndër realitetet më të hidhura që e karakterizon realitetin kosovar.

“Heshtja është krimi më i madh” është një titull i një libri të lexuar në panairin e librit në Lublanë dhe kur heshtë intelektual i është nënshtrim dhe pranim i të keqës para së keqës.

Në këtë kohë, shpikja e problemeve për të mbuluar problemet e pazgjidhura në Kosovë është trend, por për ata që ardhmërinë e këtij shteti dhe të sakrificës ekonomia dhe qëndrueshmëria ekonomike e sociale është prioritet, heshtjen ja dhurojnë së kaluarës.

Historia e ekonomisë së Kosovës jep një pasqyrë demotivuese dhe perspektivë mbi historinë e vendit e cila është gjendur vazhdimisht në sfida të mëdha, fillimisht nga shkatërrimi i ekonomisë gjatë luftës së fundit në Kosovë dhe mëpastaj nga shkatërrimi i uzurpimit dhe keq menaxhimit të proceseve ekonomike që kanë ngjallur zhgënjim jo vetëm tek resorët kyq ekonomik, por edhe tek qytetarët.

Vlenë të theksohet se kontribut më të veçantë në forcimin e themeleve të këtij shteti ka dhënë sektori privat i cili ka qenë kontribuesi më i madh në buxhetin e Republikës së Kosovës, krijuesi më i madh i vendeve të reja të punës dhe në veçanti në procesin e promovimit të ndërmarrësisë vendore. E gjithë kjo ndodhi me një situatë kur vendet e rajonit kishin çasje strategjike për të pushtuar tregun e Kosovës dhe nëse dëshironi një treg të tillë të pushtoni, atëherë duhet ta gjeni mënyrën e shkatërrimit të prodhimit të atij vendi. Një shteti që ja shkatërron prodhimin vendor, ja shkatërron edhe ekonominë në të ardhmën, duke shndërruar në shoqëri të varur nga importi dhe jo nga eksporti.

Kur këtij fakti të hidhur i shtohet edhe procesi i privatizimit që e ka përcjellë vendin tonë si një proces i cili do të shkruhet me shkronja të zeza për dëmet e bëra dhe shkatërrimin ekonomik të Kosovës ku u ndërtua në baza politike, jo transparencë, jo profesionalizëm, shkatërrim të ndërmarrjeve prodhuese vitale, ridestininim i hapsirave nga prodhimi në tregti apo ndërtim dhe shndërrimi i Kosovës në një shtet që eksporton vetëm mbeturina metalike nga këto ndërmarrje është grushti më negativ i cili e goditi Kosovën e pasluftës.

Shumë biznese të lidhura me prodhues nga vendet e rajonit dhe në veçanti nga Serbia, shfrytëzuan padijeninë e politikbërësve në Kosovë për të ju afruar dhe korruptuar dhe në këtë drejtim, shumë ndërmarrje të fuqishme tregtare u përafrian me interesat politike dhe ky kombinim e krijoi një kaos të ri në Kosovë duke e forcuar informalitetin dhe në mënyrë kontinuele duke sulmuar prodhimin “Made in Kosova”.

Kjo është edhe një dëshmi se sa ka nevojë Kosova për sundim të rendit dhe ligjit me qëllim që problemet të zgjidhen sa më parë që të jetë e mundur sepse këto probleme të grumbulluara nga e kaluara, do të jenë barrë e proceseve me të cilat do të ballafaqohet në të ardhmen.

Një politizim i cili e ka kapluar shoqërinë kosovare i cili ka gjeneruar një ç'orientim në masë dhe kur masa politizohet atëherë duhet mund dhe angazhim për një riorientim pozitiv. Në këtë drejtim si pasojë e një politizimi të tillë tentohet në masë të madhe sundimi i rendit dhe i ligjit si emërues i përbashkët i zgjidhjes së problemeve të grumbulluara nga e kaluara dhe kuptohet në një vend ku kemi mangësi ligjore e para që goditet dhe pëson është edukimi, vazhdohet me ekonominë, pason shëndetësia dhe lulëzon korrupsioni. Një situatë e tillë e ndërtuar në baza politike sa i përket punësimit ku kriter nuk është dijenia, por përkatësia politike dhe meritokracia partiake është rrugë e garantuar për dështim edhe në aspektin ndërkombëtar e në veçanti kur ka të bëjë me përceptimin dhe imazhin e Kosovës.

Është çasje e gabuar në qoftë se mendohet se Kosova do të jetë e integruar në familjen evropiane vetëm nga dimensionin politik. Duhet të kuptohet që së pari Kosovës i duhet integrim ekonomik dhe ky integrim ekonomik kërkon ndërkombëtarizim të ndërmarrësisë vendore bazuar në standardizim, certifikim, licencim, menaxhim të kualitetit dhe këtu duhet të vijë në shprehje dora e shtetit për të mbështetur sektorin privat ose të përdoret ajo dora e padukshme e Smithit që të jetë në forcim të ekonomisë vendore.

Në qoftë se do të bëhej një përshkrim substancial i periudhave më të vështira kur vendi dhe ekonomia ishte pothuajse totalisht e shkatërruar madje edhe gjendja financiare dhe inventari i kompanive kosovare pas luftës paraqiste një ndjenjë të madhe pesimizmi, por realiteti i të qenurit i lirë nga pushtuesi i cili shkaktoi këto dëme ngriti moralin e komunitetit të biznesit për të punuar dhe fuqizuar ekonominë dhe shtetin e lirë të Kosovës. Realiteti me të cilin bizneset u përballën ishte krejt tjetër, madje tejet dekurajues që dërgoi në një zhgënjim të përgjithshëm shoqëror.

Lirshëm mund të konkludohet që nuk ka përmasa të asnjë qeverie që është imun ndaj dëmtimit nga elementët mashtrues të hedhur nga një proces politik i sofistikuar. Është thelbësore përmirësimi i performancës së përgjithshme të qeverisë, izolimi i saj nga plaçkitja e grupeve oligarke dhe promovimi i llojeve të reja të iniciativës së sektorit privat. Rekomandohet direkt dhe indirekt forcimi i sistemeve gjyqësore dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave ekonomike. Këto përmirësime do të adresonin kërkesat sociale

për rendin dhe ligjin, si dhe do të lehtësonin lidhjet midis politikës dhe zbatimit për të përmbushur sfidat e varfërisë dhe të konkurrencës globale. Është esenciale të kuptohet që mbi interesat e shtetit nuk duhet të vihen interesat e partive politike dhe grupeve të caktuara të interesit dhe në këtë drejtim duhet ta kuptojmë rëndësinë e ardhmërisë. Në qoftë se mendojmë në të kaluarën, e jetojmë vetëm të sotmen do të humbim ardhmërinë dhe në qoftë se ardhmëria është vetëm disa ditë atëherë është shumë më e gjatë sesa e kaluara. Ardhmëria e shtetit tonë duhet të jetë në avancim të edukimit, në promovim të vlerave dhe jo antivlera të përceptohet si normë, por gjithnjë në partneritet me shtetet mike gjithandej. Në veçanti duhet t'i kushtohet rëndësi avancimit të bashkëpunimit me diasporën kosovare kudo në botë. Nuk e meriton ky thesar i pashfrytëzuar të analizohet dhe shfrytëzohet vetëm nga dimensionin financiar dhe kontributin e pafund që japin përmes dërgesave të tyre për stabilitet social në Kosovë.

Kosova ka nevojë për ekonomi të dijes, ambasador të shpirtit, për vlera intelektuale të testuara dhe të sfiduara në standardet më të avancuara ndërkombëtare dhe këto mund ti gjejmë vetëm tek diaspora jonë e cila lirisht mund të thuhet se shumë më tepër e dashuron Kosovën falë mallit dhe nostalgjisë për të sesa ne që derdhim lot krokodili për Kosovën dhe e shkatërrojmë çdo pore të saj.

Duhet kuptuar që në momentet e vështira e para vdes e vërteta dhe e fundit shpresa dhe në këtë drejtim edhe përkundër sfidave dhe katrahurave të kohës me të cilat ballafaqohet Kosova, rrugëtimi i saj drejtë ardhmërisë është rrugë e vendosur në binarë pa kthim që duhet të dëshmojmë se Kosova është shtet dhe do të lulëzojë në këtë drejtim drejtë familjes evropiane dhe frymës demokratike.

Safet Gërxxhaliu
Kryetar i Odës Ekonomike të Kosovës

SÉBASTIEN GRICOURT

QË NGA VITI 1999, DY DEKADA PËR NJË USHTRI TË KOSOVËS

I- 1999, Kthim në një kontekst të tensionuar

Në librin e përbashkët: “Kosova: Tregime mbi ndërtimin e një shteti”³⁸, zëvendës-komandanti i parë i KFOR-it (dhe gjenerali i parë francez i cili hyri në Kosovë), Jean-Claude Thomann përshkruan saktësisht situatën që mbizotëronte në terren, që në momentin e hyrjes së trupave të NATO-së më 12 qershor 1999. Kështu, sfida e ç’armatimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e cila ishte një synim i përcaktuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (neni 9) u vendos qysh në ditët e para dhe përgjatë verës që pasoi.

Gjenerali francez rrëfen vështirësitë për arritjen e një marrëveshje, në një kontekst ku në njërën anë, lidershipi i UÇK-së ushqente divergjenca të brendshme që vështirë kuptoheshin nga jashtë, kurse në anën tjetër kishte dëshirë për të qeverisur vetëm ai, në dëm të aktorëve të tjerë politik.

Për ta zhblokuar këtë situatë u propozua ideja - e cila vinte nga Franca - e transformimit të UÇK-së në një lloj ushtrie të gjeniut, një organ i sigurisë civile. Kjo mundësoi një kompromis të madh: i jepej fund karakterit të armatosur të UÇK-së pa e shpërbërë atë. Natyrisht se ky kompromis nuk ishte i njëzëshëm në mesin e shteteve partnere në KFOR ose në UNMIK, të cilët kundërshtnin shtrirjen e strukturës, pamja ushtarake dhe uniforma e së cilës perceptoheshin si “shkelje” e rezolutës 1244.

Megjithatë, nga këndvështrimi i KFOR-it, që ishte institucioni i vetëm ndërkombëtar funksional në ato muajt e parë të Kosovës së çliruar, kjo zgjidhje e pranuar në shtator të vitit 1999 jetësonte qëllimin. Neutralizonte një fuqi dëmtuese “duke e zbrazur nga kapaciteti për veprime ushtarake dhe duke e shndërruar në një strukturë nën kontrollin e ngushtë të bashkësisë ndërkombëtare, pa nxitur reagime të dhunshme nga forcat shqiptare në një kohë kur të gjitha përpjekjet përkushtoheshin për kthimin e normalitetit në rajon³⁹”.

³⁸ Botuar në vitin 2014 në shtëpinë botuese Non lieu, Paris, me bashkëdrejtimin e Sébastien Gricourt dhe Gilles Pernet.

³⁹ Op. cit., pjesa e parë « Prej çlirimit në pavarësi », « Tregimi mbi çarmatimin të UÇK », faqe 30.

II - Fillimi i procesit të çarmatimit, çmobilizimit dhe riintegritimit (DDR)

Pra, marrëveshja themeluese e DDR-së në Kosovë daton nga 20 qershori 1999. E titulluar «Ndërmarrja e çmilitarizimit dhe transformimit të UÇK-së», përmbajtja e saj - sipas fjalëve të hulumtimit studimor të Nathalie Duclos⁴⁰ - ilustron fenomenin e «përplasjes dhe marrëveshjes së fshehtë» në mes aktorëve ndërkombëtar dhe kombëtar.

Kjo marrëveshje përmban një pajtim të rëndësishëm në lidhje me atë që mbetet edhe sot mandati i KFOR-it lidhur me rezolutën 1244. Kështu, në dy paragrafët e nenit 25 të marrëveshjes përfshihet riklasifikimi i anëtarëve të UÇK-së në administratën e ardhshme të Kosovës duke përfshirë policinë dhe krijimin e modelit të një ushtrie të ngjashme me forcën ushtarake rezervë që është Garda Kombëtare e SHBA-ve.

Përballë këtyre koncesioneve, veçanërisht të ushqyera nga premtimet e nxituara për pavarësi të shtyera nga disa aleatë perëndimor, u deshën tre muaj negociatash të rrepta për ta pranuar propozimin francez si të vetmin të mundshëm në kontekstin e atëhershëm. Megjithatë, marrëveshja e 21 shtatorit 1999, e cila zyrtarizon transformimin e UÇK-së në Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) / Kosovo Protection Corps, do ta ruajë dykuptimësinë fillestare të marrëveshjes së 20 qershorit 1999, duke pasur parasysh se në gjuhën shqipe termi “Mbrojtje” nënkupton të mbrohesh dhe të mbrosh.

Pra, mund të thuhet se TMK-ja është plotësisht një bashkëprodhim (ko-produksion) ndërkombëtar dhe lokal, një pazar i gjatë ku nuk mungonin zhvatjet mbi rreziqet që mund të rezultojnë nga pakënaqësia e ish-luftëtarëve.

Nëse rezultati doli të jetë i papritur, këto ndërvarrësi mundësuan një kompromis i cili dukej atëherë i nevojshëm për ta siguruar stabilitetin e vendit. Kjo fazë na solli në këtë kohë të ashtuquajtur të “stabilitokracisë”, nga e cila nuk kemi dalur ende sipas meje dhe që po ngadalëson ndërtimin e plotë të shtetit demokratik të së drejtës.

Në të vërtetë, ky proces i DDR-së i mundësoi disa figurave të UÇK-së ta ndërtojnë legjitimitetin politik duke përfituar nga boshllëku politik dhe institucional, ku kishte rëndësi vetëm urgjenca e stabilizimit. Në këtë periudhë tensionesh, ku UNMIK-u priti vjeshtën për ta rritur fuqinë, këta

⁴⁰ Nathalie Duclos, tetor 2015, « The DDR in Kosovo: collision and collusion among international administrators and combatants », Peacebuilding, 4:1, 2016, faqet 41-53.

aktorë lokalë perceptoheshin si të domosdoshëm për paqëtimin. Dihet po ashtu se kjo periudhë njohu incidente dramatike, ku ndërkombëtares e hutuar zbuluan ndarjet e viteve '90, në mes të kampit të luftës paqësore dhe kampit të luftës së armatosur.

Derisa këto dy kampe që përbëjnë historinë bashkëkohore të Kosovës kishin urat e tyre, ata kishin gjithashtu rivalitetet dhe grindjet e tyre të cilat ekzistojnë ende sot.

Përsa i përket rekrutimit të anëtarëve të TMK-së, edhe pse ishin ndërkombëtarët ata që krijuan mekanizmin e përzgjedhjes, udhëheqësit e UÇK-së ishin ata që e zotëronin me të vërtetë. Sigurisht, KFOR-i e kishte parasysh realitetin, sepse sërish, në emër të stabilitetit që i paraprinte rindërtimit, TMK-ja dukej një "instrument i kontrollit social për të kontribuar në paqëtim".

Duke u bazuar në këtë, ish-përfaqësuesi politik i UÇK-së, tani Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, që drejtonte asokohe qeverinë e përkohshme të vendosur në qershor 1999, u përpoq që t'i rekrutonte me të njëjtën metodë ish-luftëtarët e UÇK-së në polici (Shërbimi Policor i Kosovës, SHPK), në përputhje me kushtet e marrëveshjes së 20 qershorit.

Duke pretenduar një numër prej 20/25.000 luftëtarësh, ai kërkoi që 2000 prej tyre të bëhen pjesëtar të SHPK-së, ose 50% i numrit të përgjithshëm të tyre në të ardhmen. Presidenti Ibrahim Rugova ndërhyri ndaj kërkesave të rivalit të tij. Atij ju aprovua kërkesa që pragu i pjesëtareve policor nga radhët e UÇK-së të ishte nën 40%, ndërsa një e katërta e numrit të përgjithshëm të ishte e rezervuar për mbështetësit e tij që dikur ishin policë.

Kësaj herë, ndërkombëtarët kishin arritur ta kontrollonin më mirë procesin e rekrutimit, duke përdorur mosbesimin e ndërsjellë midis përfaqësuesve politikë. Ata kishin punuar për ta ribalancuar raportin e forcës në mes dy blloqeve (të cilat nuk janë asesi homogjene), sepse sikurse TMK-në, ata e shihnin edhe SHPK-në si një instrument të kontrollit social.

Kështu që DDR-ja u shpërfaq të jetë në Kosovë një strategji shumë politike që (ri)legjitimoi aktorët politikë. Megjithatë, të kemi parasysh se në kontekstin e atëhershëm të "stabilitokracisë", veprimi i tillë mundësoi ndarjen brenda UÇK-së të elementëve që konsideroheshin më "radikalë" nga ata që konsideroheshin "më të moderuar, më të arsyeshëm".

III - Procesi i transformimit të TMK-së

Qofshin ato provokim vullnetar apo instrumentalizim i improvizuar pas shpërthimit të tyre, trazirat e vitit 2004⁴¹ shënonin pamohueshëm zemërimin dhe humbjen e durimit ndaj moszgjidhjes së statusit të Kosovës.

Në lidhje me temën tonë, raporti i Kai Eide-së në 2005, që lansoi idenë e «standardeve para statutit», nënvizonte «profesionalizmin në rritje» të TMK-së, por gjithashtu edhe shkallën e ndieshmërisë të çështjes. Kësisoj, ai sugjeroi që të lidhet «roli i saj i ardhshëm» me «procesin e shtetit të ardhshëm» (neni 25).

Pra, fjala ishte për menaxhimin e pritjeve duke përmendur perspektivat ekzistuese.

Por në vitin 2007 “Propozimi i Detajuar për një Zgjidhje të Statutit të Kosovës” të diplomatit finlandez (“Paketa e Ahtisarit”) do ta qartësoi diskursin ndërkombëtar duke propozuar themelimin e “Forcës së Sigurisë së Kosovës ... lehtësisht të armatosur” (neni 9.4). Kjo do të implementohej pas shpërbërjes së TMK-së, vitin pas hyrjes në fuqi të tekstit, si dhe pas përfshirjes së tij në Kushtetutën e Kosovës, e cila do të hyjë në fuqi më 15 qershor 2008.

Forcat e Sigurisë së Kosovës (FSK) do të krijohen pra më 21 janar 2009. Ato përbënin një fazë të re të një kompromisi në mes vullnetit në Kosovë për të krijuar Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK) dhe vullnetit të ndërkombëtarëve për të mos i ndezur tensionet tashmë të forta, me Rusinë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së dhe me Serbinë pas shpalljes së njëanshme të pavarësisë.

Por, siç e përcaktonte Paketa e Ahtisarit, Kushtetuta do ta ketë një “Rishikim Strategjik” (neni 127) që do të krijonte Këshillin e Sigurisë së Kosovës, përgjegjësia e të cilit është e Qeverisë, në konsultim me Presidencën. Këtu duhet theksuar pasaktësinë e narativit zyrtar i cili ilustron presionin e vazhdueshëm për ta përshpejtuar formimin e FAK-ut, siç shprehet zëshëm për shembull nga ish-Ministri i Jashtëm Enver Hoxhaj në librin e tij “Ngritja e një Shteti” (2015).

Ai pohon se Paketa e Ahtisarit premtoi formimin e FAK-ut deri në mes të vitit 2013, por në fakt ishte perspektiva e një “Rishikimi Strategjik” që ishte

⁴¹ Radhazi me 15 dhe 16 mars, një i ri serb vritet në një fshat në qendër të Kosovës dhe protesta të shoqatave të veteraneve të UÇK-së denoncojnë arrestimin e komandateve për krime të luftës të dyshuar. Atë ditë, lajmi i mbyttjes së 4 fëmijëve në lumin Ibër në veri të Kosovës, ku pretendohet se ishin shtyer në lum nga banor serb, shkaktonte trazira në të gjithë vendin kundër shtëpive dhe kishave serbe. Shkaktuan vdekjen e tridhjetë personave.

përcaktuar (Neni 5.3) për t'i shqyrtuar kufizimet e mandatit të FSK-së. Kjo nuk nënkupton automatikisht që ky proces do ta sillte një ndryshim të mandatit, misioneve, përbërjes dhe transformimit në FAK brenda afatit kohor të caktuar.

IV - 2013: Përshpejtimi i kërkesës së transformimit të FSK-së në FAK.

Zyrtarisht, mbikëqyrja ndërkombëtare e zbatimit të Paketës së Ahtisarit mbaron me mbylljen e Zyrës së Përfaqësuesit civil ndërkombëtar në shtator 2012. Kësisoj, kapaciteti i plotë operacional i FSK-së do të shpallej nga NATO-ja më 9 korrik 2013. Në mes të këtyre dy datave, marrëveshja Serbi-Kosovë e 19 prillit 2013, nënshkruar me mbikëqyrjen e BE-së nga të dy kryeministrat (Ivica Dačić dhe Hashim Thaçi) hapi një periudhë të re të marrëdhënieve në mes dy vendeve, në bazë të parimeve të pranuara nga të dyja palët për të ecur drejt normalizimit të marrëdhënieve të tyre.

Por, megjithë interpretimet divergjente të shprehura nga nënshkruesit në opinionin publik të vendeve të tyre, kjo marrëveshje shënon gjithashtu fillimin e vështirësive të përfaqësuesve politik të cilët duhet të pranojnë kompromise jogjithpërfshirëse të imponuara nga lartë. Këto lloj marrëveshje të njëpasnjëshme do ta dobësojnë në veçanti palën kosovare, sepse ajo duket më shumë një vegël për dialog, se si një palë dhe një fuqi propozuese.

Në këtë kontekst, agjenda e krijimit të FAK-ut duket e vetmja alternativë për konsensus politik, natyrisht përveçse për një pjesë të madhe të serbëve të Kosovës. Rivendosja e temës së FAK-ut mundëson riafirmimin e autoritetit të humbur, rifitimin e besimit, e mbase edhe kundërshtimin e sforcuar ndaj përfaqësuesve ndërkombëtar.

Në mars 2014, botimi i « Revue stratégique » për sektorin e sigurisë duket si dokumenti i parë po aq eksplicit sa ai i 20 qershorit 1999, pasi e parasheh transformimin e FSK-së në FAK.

Kësisoj, viti 2015 do të veçohet me debate në përkrahje të themelimit të FAK-ut. Por, këto debate nuk do ta mundësojnë mbulimin e çështjeve të tjera më të ndieshme, pasi që ishin bërë kompromise të pakuptueshme dhe marrëveshje që shpërfillnin popullatën dhe kuvendin: marrëveshja për krijimin e Asociacionit të komunave serbe të Kosovës, marrëveshja për demarkacionin kufitar në mes Malit të zi dhe Kosovës, amandamentet e imponuara kushtetuese për të mundësuar delegimin e pushtetit të nevojshëm për themelimin e « Gjykatës Speciale » për të gjykuar krimet

e dyshuara të UÇK-së. Duhet theksuar përndryshe se me këtë rast është mundësuar ndryshimi i Kushtetutës në mënyrë arbitrare, ndryshe nga trajtimi për transformimin e FSK-së në FAK, që mundet të ndodhë vetëm se në përputhje të plotë me Kushtetutën (miratimi me 2/3 e votave të parlamentit).

Në këtë kontekst të tensionuar politik që e dobësonte dyshen kryetar-kryeministër, PDK-LDK, në nëntor 2015 kryeministri Isa Mustafa i kërkoi me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-së Jens Stoltenberg-ut që të krijohet një raport i ri politik midis Aleancës Atlantike dhe Kosovës, përmes një sërë fushash që lidhen me çështjet e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Përgjigjja zyrtare do të vjen në Prishtinë në dhjetor 2016, pasi që Këshilli i NATO-së ishte pajtuar mbi nevojën e një mënyre të re të bashkëpunimit. Përgjigja e ushqente shqetësimin e vazhdueshëm të menaxhimit të pritjeve të kosovarëve dhe ruajtjen e barazpeshës së mandatit të KFOR-it në lidhje me Rezolutën 1244. Prandaj çështja ishte që Kosovës t'i jepej një qasje graduale në programet e ndryshme të NATO-së.

Kjo përgjigje e NATO-së përmban mjaft dykuptimësi për t'i lënë hapësirë manovrimit dhe negociatave për shkallën e integritit të FSK-së në këto programe. Në vitin 2017, fjala kryesore midis FSK-së dhe NATO-së ishte "bashkëveprim i shtuar", që i mundësonte diskurseve zyrtare të përsërisnin premtimin për një anëtarësim të shpejtë.

Por kjo nuk nënkupton që Kosova gëzon plotësisht statusin e "shtetit partner". Ky status është i pamundur për aq kohë sa katër nga vendet anëtare të NATO-së nuk e njohin pavarësinë e Kosovës: Qiproja, Greqia, Rumania dhe Spanja, kundërshtimi i së cilës për Kosovën është ringjallur që nga kriza e Katalonisë.

Pavarësisht nga pritjet e Kosovës, NATO-ja nuk do të rrezikojë të minojë "neutralitetin" e saj, veçanërisht pasi që Serbia është e integruar në njërin nga programet më të larta që shpie në integrim: Partneriteti për Paqe. Në mënyrë më të përgjithëshëm, sjellja e NATO-së ndaj Kosovës lidhet natyrshëm me vullnetin për të mos shënuar haptazi një vijë tjetër konfrontimi me Rusinë, pasi që përfshirja e saj në Ballkan tanimë është shqetësim i madh.

Ky "bashkëveprim i shtuar" krijoi kështu një kontakt të drejtpërdrejtë ndërmjet Kosovës dhe NATO-së, pa kaluar nëpër selinë e saj qendrore në Bruksel. Ai mori trajtën e një ekipi këshillëdhënës dhe ndërlidhës të NATO-së, të formuar brenda FSK-së dhe ministrisë së FSK-së. Një ekip, embrioni i të

cilit kishte ekzistuar qysh nga gushti 2016.

Derisa në nëntor 2017 merrja pjesë në një konferencë në Kosovë për sfidat e sigurisë në Ballkan, mësova se kjo ngjarje e nivelit të lartë ishte e para e këtij lloji e organizuar në kuadër të Programit të Diplomacisë Publike.

Programi Integriteti duhet të jetë aktiviteti tjetër i NATO-së në të cilin do të integrohet Kosova. Ai ka për qëllim zhvillimin e kapaciteteve të qeverisjes së mirë në fushat e bashkëpunimit të sigurisë dhe të luftës kundër korrupsionit. Duhet të theksohet se FSK-ja tashmë zbatonte planin e saj të Integritetit. Potencialisht, Kosova mund të hyjë në Programin për Shkencën, Paqen dhe Sigurinë që mbledh shkencëtarë, ekspertë, civilë dhe ushtarakë.

Ekziston gjithashtu një interes i theksuar i NATO-së që Kosova të integrojë programin e mbrojtjes kibernetike, të edukimit, trajnimit dhe logjistikës.

Është po ashtu është shumë e mundshme që FSK-ja të bashkohet me ushtrimet dhe shkëmbimet e përvojave të Qendrës euro-atlantike bashkërenduese të përgjigjeve ndaj fatkeqësive, duke pasur parasysh përvojat e fituara që nga TMK-ja, por edhe për shkak se mbrojtja civile mbetet korniza e mandatit dhe misioneve të saj.

Siç kam pasur rastin ta sugjeroj në vitet e fundit, insistoј në faktin se Kosova duhet ta marrë parasysh përfshirjen në bashkëpunime strategjike shtesë. Në të vërtetë, duke pasur parasysh qëllimin e integritetit në BE, Prishtina duhet të jetë proaktive për t'i nxitur vendet e BE-së për të ftuar FSK-në në misionet e ndryshme evropiane, nën mandatin e Politikës të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Përbashkët, sikurse Serbinë ose Maqedoninë.

Kjo do të kishte përparësi të dyfishtë: do të ishte në përputhje me nivelin e lartë të bashkëpunimit që ekziston në mes të NATO-së dhe BE-së, dhe do ta demonstronte po ashtu në këtë fushë angazhimin e Kosovës në një perspektivë evropiane, duke ndikuar edhe në pesë vendet anëtare të BE-së që nuk e njohin pavarësinë.

V - Përfundim: Cila Ushtri për cilin sovranitet ?

Për t'iu kthyer NATO-së, pra shihet që ekziston një gamë e gjerë sferash bashkëpunimi. Ato do të jenë sigurisht subjekt për negociata, por në fund, ato kontribuojnë në rritjen e profesionalizmit të FSK-së, në përtërirjen e stafit të saj, "trupave" të saj, por edhe për të fituar kohë, para se të përmbushen kushtet për krijimin e FAK-ut.

Pa u vonuar në këto çështje teknike dhe politike, megjithëse janë thelbësore,

do të përfundoja duke parashtruar dy pyetje të cilat duhet të ushqejnë debate në të ardhmen përtej temës së vetme të FSK / FAK :

1/ A mund të ketë vërtetë një Ushtri të plotë të Kosovës duke pasur parasysh se vendi nuk e gëzon ushtrimin e plotë të sovranitetit të tij, me ose pa 1244, me ose pa kontrollin e kufirit të saj me Serbinë? Sipas mendimit tim, nëse FAK-u krijohet në kontekstin e tanishëm ligjor, ajo do t'i ruajë misionet aktuale të FSK-së dhe do të mbetet lehtësisht i armatosur - edhe nëse një strukturë komanduese e tipit ushtarak mund ta bëjë FAK-un të ngjashëm me një Ushtri - por në fund, kjo do të jetë një hap cilësor shtesë.

2/ Në mënyrë më provokuese, unë do të pohoja se menaxhimi i kohës ka gjithashtu të bëjë me nxitjen drejt daljes të elementeve që kanë mundur të jenë të dobishme ose penguese më 1999, e në këtë kuptim, vlenë të shihet se cilat do të jenë pasojat e aktakuzave të mundshme të Gjykatës Speciale. Sado e padrejtë mund të jetë kjo gjykatë në lidhje me dështimet e grumbulluara nga drejtësia e UNMIK-ut dhe të EULEX-it, a do të jetë ajo në fund një mjet ku ndërkombëtarët do të mundohen t'i përmirësojnë disa gabime vlerësimesh, pendime mbi përplasjet-marrëveshjet e fshehta të dikurshme? Vallë, "stabilitokracia" do t'ia lëshoj më në fund vendin ushtrimit të demokracisë së vërtetë ...?

Sébastien Gricourt

Ekspert i asocuar në Fondacionin Jean Jaurès, ish-këshilltar politik në Ballkan (OKB, NATO), Bashkautor i botimit të librit « Kosova : rrëfime mbi ndërtimin e një shteti » (Sht.botuese Non Lieu, 2014)

info@iseal.ch
www.iseal.ch

ISBN: 978-2-9701283-2-8